PROGRAMI PËR ZHVILLIM RURAL 2018

MASA 101: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE TË EKONOMIVE BUJQËSORE

UDHËZUES PËR APLIKUES

Afati i aplikimit 19 Mars – 30 Prill 2018

PËRMBAJTJA

OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARE PËR KËTË MASË 4
1.1. Hyrje 4
1.2. Objektivat e masës 5
1.3. Buxheti 5
1.4. Përkufizimet kryesore 5
1.5. Përfituesit përfundimtar 7

2. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË 8
2.1. Aplikuesit e pranueshëm 8
2.2. Standardet kombëtare 8
2.3. Qëndrueshmëria ekonomike 8
2.4. Kriterët tjera të pranueshmërisë 8

3. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË 10
3.1. Sektori i pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni) 10
3.2. Sektori i perimeve dhe serrave (përfshirë patatet) 10
3.3. Sektori i mishit 10
3.4. Sektori i qumështit 11
3.5. Sektori i rrushit 11
3.6. Sektori i vezëve 12

4. INVESTIMET E PRANUESHME 12
4.1. INVESTIMET E PRANUESHME PËR SEKTORË 12

5. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR NËNSEKTORË 14
Tabela 1: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e pemëve 14
Tabela 2: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e perimeve dhe serrave (përfshirë patatet) 15
Tabela 3: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e mishit 16
Tabela 4: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e qumështit 17
Tabela 5: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e rrushit 17
Tabela 6: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e vezëve 18

6. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE 19

7. INDIKATORËT E PROGRAMIT 19
Tabela 7: Treguesit e monitorimit 19

8. PROCEDURA ADMINISTRATIVE 20

9. AFATI I ZBATIMIT 20

10. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS 21
10.1. Rregullat për shpenzimet e pranueshme 21
10.2. Shpenzimet e papranueshme 21

11. PROCEDURAT E APLIKIMIT 22
11.1. Përmbajta e aplikacionit 22

11.2. Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit 23
11.3. Vlerësimi, përzgjedhja, kontraktimi dhe implementimi 23
11.4. Vlerësimi i planit të biznesit ose i projekt-propozimit 23
11.5. Kontrollet në terren 24
11.6. Radhitja në listë 26
11.7. Procedurat e dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit 26
11.8. Kontrata mes përfituesit dhe AZHB-së, bashkë me procedurat e prokurimit 26
11.9. Monitorimi Ex-post 27

12. LISTA E SHTOJCAVE 28
Shtojca nr. 1 Formulari i aplikimit për masën 101 28
Shtojca nr. 2 Lista e dokumenteve të dorëzuara 30
Shtojca nr. 3 Model për përgatitjen e projekt-propozimit 33
Shtojca nr. 4 Model për përgatitjen e planit të biznesit 37
Shtojca nr. 5 Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural 46
Shtojca nr. 6 Standardet minimale kombëtare për PBZHR- 2018 55
Shtojca nr. 7 Lista e investimeve të pranueshme 58
Shtojca nr. 8 Lista e vendbanimeve (zonat kadastrale) në zonat malore (“lloji A”) 67
Shtojca nr. 8/2 Lista e vendbanimeve (zonat kadastrale) në zonat malore (“lloji B”) 73
Shtojca nr. 9 Kërkesa për pagesë 74
Shtojca nr. 10 Raporti i Vlerësimit 79
Shtojca nr. 11 Forma e ankesës për fermerë 79
Shtojca nr. 12 Kontaktet dhe vendet informuese për aplikim 81
Shtojca nr. 13 Formulari për mbledhjen e treguesve të monitorimit 81
Shtojca nr. 14 Plani i biznesit - Pjesa financiare 88
Shtojca nr. 15 Promovimi 89
Shtojca nr. 16 Kodi i Etikës për kompanitë këshilluese 89
Shtojca nr. 17 Numri i vendeve të reja të punës 90
Shtojca nr. 18 Kushtet specifike për ndërtimin e serrave 91
Shtojca nr. 19 Deklarata nën betim 91

OBJEKTIVAT, PRIORITETET DHE MJETET FINANCIARE PËR KËTË MASË

1.1. Hyrje

Udhëzuesi ka për qëllim t’u ndihmojë aplikuesve në përgatitjen e aplikacioneve të tyre, të qartësojë kushtet e pranueshmërisë që duhet të respektohen, sistemin e pikëve, cilat janë investimet e pranueshme, cilat janë dokumentet e nevojshme për aplikim, si do të bëhet vlerësimi i projekteve, si do të njoftohen aplikuesit për rezultatet e vlerësimit, cilat janë procedurat e prokurimit, cilat janë ndëshkimet në rast të parregullsive apo tentimeve për mashtrim etj.

Roli i Udhëzuesit është të sqaroj në detaje dispozitat e paraqitura në masë dhe jo të përsërisë atë, prandaj ky nuk e zëvendëson masën por duhet lexuar (bashkë me shtojcat),me qëllim të shmangies së gabimeve gjatë aplikimit.

Kjo masë përfshinë 6 sektorë: pemët, perimet, mishin, qumështin, rrushin dhe vezët. Masa është përgatitur nga personeli i Autoritetit Menaxhues duke u bazuar në studime të pavarura për sektorë, këshillime me palët e interesit.

1.2. Objektivat e masës

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit;
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- Përkrahja e bujqve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së;
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

1.3. Buxheti

Ndarja e planifikuar buxhetore ndërmjet sektorëve për vitin 2018

Sektorët		Vlera në €	% e buxhetit
101.1 Pemët	Për pemë drufrutore	2,500,000	20.83
101.2 Perimet	Serra	3,000,000	25.00
	Depo për ruajtje të perimeve dhe pemëve	500,000	4.17
101.3 Mishi	Trashja (majmëria) e viçave	2,000,000	16.67
	Trashja e derrave	300,000	2.50
101.4 Qumështi	Prodhimi i qumështit nga lopët,	2,000,000	16.67
	Prodhimi i qumështit nga delet dhe nga dhitë	700,000	5.83
	Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	200,000	1.67
101.5	Sektori i rrushit	500,000	4.17
101.6	Sektori i vezëve	300,000	2.50
Gjithsej:		12,000,000	100%

1.4. Përkufizimet kryesore

Shkalla e përkrahjes publike –është pjesëmarrja (e shprehur në përqindje) e mjeteve publike në shpenzimet e pranueshme;

Aplikues – janë personat fizik apo juridik që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të paraqitura në këtë dokument dhe të cilët paraqesin kërkesë për të përfituar nga grantet e zhvillimit rural;

Aplikacion – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të kërkuara në Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë;

Përfitues – personi fizik apo juridik i cili është deklaruar përfitues pas vlerësimit të aplikacionit dhe që ka nënshkruar kontratë me Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë;

Thirrja për aplikim – njoftimi publik për pranimin e aplikacioneve;

Kontrata –nënkupton kontratën që nënshkruhet në mes të aplikuesit të përzgjedhur dhe Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, sipas modelit të parapërgatitur, shih shtojcën nr. 4;

Kontrata për dorëzim të së paku 50% të prodhimit duhet të përmbajë së paku këto elemente:

- Të dhënat e palëve kontraktuese
- Llojet dhe sasitë e prodhimeve (në kg ose litra dhe ne %) që do të dorëzohen
- Datën e lidhjes së kontratës,
- Vula dhe nënshkrimi i blerësit të prodhimeve dhe nënshkrimi i prodhuesit

Sasia prej 50% apo më shumë duhet të përputhet me sasinë e paraparë në planin e biznesit

Kontrata për mbikqyrje profesionale- lidhet në mes të përfituesit të grantit dhe këshilltarit të certifikuar apo kompanisë së licensuar nga MBPZHR-ja. Listat e këshilltarëve të certifikuar dhe kompanive të licensuara do të publikohen në www.azhb-ks.net dhe www.mbpzhr-ks.net.

Shpenzimet apo investimet e pranueshme – janë shpenzimet apo investimet që përkrahen me mjete publike, shih shtojcën nr. 6;

Pemë drufrutore – në kuadër të këtij programi nënkuptohen: molla, dardha, kumbulla, pjeshka, kajsia, qershia, ftoni, vishnja, arra dhe lajthija.

Periudha e monitorimit Ex-post – periudha kohore prej 5 vjetësh pas përfundimit të investimit, gjatë të cilës përfituesi duhet ta ruajë qëllimin e investimit dhe të gjitha kushtet sipas të cilave ai është përzgjedhur dhe ka marrë pikë;

Grant – ndihma financiare publike e pakthyeshme e dhënë nga Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë për shpenzimet e pranueshme;

Autoriteti Menaxhues – entitet publik brenda MBPZHR-së i organizuar si Departament me përgjegjësi kryesore në hartimin dhe monitorimin e programit;

Masa – dokument teknik që paraqet njësinë bazë të programit dhe pjesët kryesore të saj janë kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes së aplikuesve. Masa ka buxhetin e saj përmes të cilit synohet të arrihet ndikim i caktuar.

Masa zbatohet përmes thirrjes për aplikim dhe procesit të vlerësimit të projekteve.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë- është Agjenci e Pagesave (www.azhb-ks.net) me përgjegjësi kryesore në vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve, si dhe pagesën e shpenzimeve sipas procedurave të parapara;

Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 – është dokument teknik i cili përcakton masat e zhvillimit rural, logjikën e intervenimit dhe ndikimin e pritur të granteve;

Projekt – investimi i planifikuar i dorëzuar nga aplikuesi;

Periudha e implementimit të projektit – koha prej nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi),deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit nga AZHB-ja;

Përzgjedhja – përcaktimi i numrit të pikëve për aplikuesit e pranueshëm, radhitja e tyre në listë sipas pikëve dhe deklarimi i tyre "i përzgjedhur për financim" dhe shpërndarja e mjeteve financiare duke filluar nga ata në krye të listës.

PËRVOJA E APLIKUESIT mund të dëshmohet me mundësitë vijuese:

a) Aplikuesi është person juridik me aktivitet primar prodhimin bujqësor;

b) Aplikuesi është i regjistruar në Regjistrin e fermës së paku dy vjet para aplikimit;

c) Aplikuesi ka punuar së paku dy vjet në një ndërmarrje bujqësore ose

d) Aplikuesi ka të kryer shkollën e mesme bujqësore apo fakultetin e bujqësisë

Në të katër rastet duhet të dëshmohet me dokumentin përkatës. Këta aplikues nuk kanë nevojë për trajnime.

Zgjerim: për nevoja të këtij Programi, termi "zgjerim" nënkupton ndërtim në vazhdim të objektit ekzistues ose aneks i bashkuar fizikisht me objektin i cili zgjerohet. Ndërtimi i një objekti të ri pranë ose larg objektit ekzistues nuk trajtohet si zgjerim. Për çdo zgjerim me sipërfaqe mbi 10 m² kërkohet leje e ndërtimit.

Sqarime shtesë:

Kriteri i përzgjedhjes: "**Përvoja në prodhimin përkatës: aplikuesi ka lopë qumështore/viça/dele/dhi/derra/ në prodhim"** dëshmohet përmes vërtetimit nga Regjistri për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve. Ky fakt verifikohet edhe gjatë kontrollit të parë në teren, para nënshkrimit të kontratës. Nëse në momentin e kontrollit në teren numri i kafshëve është më i vogël se ai i paraqitur në aplikacion i vetmi arsyetim i pranueshëm është therrja në thertore të licencuar ose dëshmia e veterinarit të zonës se kafsha ka ngordhur.

Certifikata e Fermerit (NIF) duhet të jetë në emër të aplikuesit. Në rast kur aplikuesi është ndërmarrje, edhe NIF-i duhet të jetë në emër të ndërmarrjes.

1.5. Përfituesit përfundimtar

Përfituesit përfundimtar në këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04/L-090 –Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 - Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Të gjithë aplikuesit e kësaj mase duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermave. Certifikata e Numrit Identifikues të Fermës (NIF) duhet të jetë në emër të aplikuesit. Nëse aplikuesi është ndërmarrje, edhe Certifikata e NIF-it duhet të jetë në emër të ndërmarrjes.

Të gjithë përfituesit e projekteve të Zhvillimit Rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë pesë viteve pas realizimit të projektit, aq sa zgjatë periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike.

2. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

2.1. Aplikuesit e pranueshëm

- Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, që nuk i ka mbushur 61 vjet. Në rastin e ndërmarrjeve ky kriter nuk aplikohet;
- Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar) dhe dy vjet përvojë pune në lëmin në të cilën aplikon. Aplikuesit që nuk kanë përvojë pune dy vjeçare, duhet të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi, në fushën për të cilën aplikojnë, e të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit;
- Në rastin e ndërmarrjeve, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin ose për personin e autorizuar të ndërmarrjes. Personi i autorizuar duhet të ketë kontratë pune së paku edhe për tri vjet; pas momentit të aplikimit.
- Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore dhe atë, personat fizik, tatimin në pronë, kurse ndërmarrjet, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;

2.2. Standardet kombëtare

Standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit janë të paraqitura në Shtojcën nr. 5 të Udhëzuesit për aplikant. Ato duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe verifikohen me kontrollin e personit zyrtar në vendin e investimit.

2.3. Qëndrueshmëria ekonomike

- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një projekt-propozim teknik sipas modelit që do të publikohet në ueb faqet e AZHB dhe MBPZHR.
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit që do të publikohet në ueb faqet e AZHB dhe MBPZHR. Investimet e planifikuara duhet të jenë në perputhje me kapacitetin prodhues. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, duke u bazuar në planin e biznesit, zyrtarët e AZHB-së janë të obliguar të refuzojnë pjesën e investimeve të cilat janë në kundërshtim me këtë parim.

2.4. Kriterët tjera të pranueshmërisë

Përfituesit e projekteve me vlerë të investimeve të pranueshme në shumën më të madhe se 50,000 €, para nënshkrimit të kontratës me AZHB, duhet t'i regjistrojnë ndërmarrjet e tyre dhe të gjitha investimet/shpenzimet duhet të faturohen në emër të kësaj ndërmarrjeje.

Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2018 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër,

atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin.

Të gjithë përfituesit e masës 101, këshillohen që gjatë periudhës monitoruese të mbajnë librin e fermës për sektorin përkatës.

Numri i vendeve të reja të punës do të llogaritet sipas tabelës në shtojcën nr. 17.

Përfituesi, i cili ka aplikuar në MBPZHR dhe institucione tjera publike apo në zyrën e BE-së në Kosovë dhe projekti i tij përzgjidhet për financim nga ndonjëri prej institucioneve, duhet menjëherë të informojë MBPZHR / AZHB apo institucionet tjera përkatëse.
Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përmbyllur në mënyrë të rregullt.

Të gjitha asetet që kanë të bëjnë me investimin (toka, stallat, kafshët, pemishtet etj.) duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermës.
Të gjitha kontratat e qiramarrjes duhet të jenë të noterizuara, përveç kontratave të qiramarrjes me Agjencionin e Pyjeve të Kosovës (APK) dhe me Komuna të cilat nuk ka nevojë të jenë të noterizuara.

Në rast të tokave të marra me qira nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit, kontratat mund të jenë edhe për kohë më të shkurtër se sa është e paraparë për aplikuesit e tjerë, me kusht që ata të dorëzojnë një vërtetim nga qiradhënësi se nuk do të ketë problem me vazhdimin e kontratës.
Tokat e privatizuara nga AKP, të cilat në certifikatën e pronës paraqiten si "tokë e marrë me qira për 99 vjet" trajtohen si tokë në pronësi privatizuesit.

Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim apo zgjerim, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Certifikata e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi;
- Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit;
- Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;
- Pëlqimin e Komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë leje ndërtimi;

Në rastin e projekteve që parashohin renovim, aplikuesit, me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Parallogarinë e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;

Përfituesi, para se të bëjë kërkesën për pagesë në AZHB, duhet të dorëzoj:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës.

Në rast të ndërtimit, zgjerimit apo renovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes, vreshtit dhe / apo vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit.

- Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që do të bëhet në tokën e tij.

Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit,

prindërit, fëmijët, nipërit, etj.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës apo certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësoj 'Deklaratën nën betim' (shtojca nr. 12), me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon është trashëguar nga ai.

3. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË

3.1**.** Sektori i pemëve (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni)

- Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 1 hektar. Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.35 hektar;
- Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.
- Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.

3.2. Sektori i perimeve dhe serrave (përfshirë patatet)

- Në momentin e aplikimit për investime në depo për pemë dhe perime (përfshirë pataten), aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 2 hektarë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet.
- Në momentin e aplikimit për investime në serra të reja të përhershme, aplikuesi duhet të dëshmoj se ka së paku 0.10 hektar tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave.
- Serrat duhet të ndërtohen sipas kushteve të parapara në shtojcën nr.18.

3.3. Sektori i mishit

- Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave dhe derrave), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë viça/derra në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça, ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse* dhe me praninë e tyre në stallë. Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça dhe për derra, në projektin

e tyre duhet ta përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se kanë së paku 0,20 hektar të tokës bujqësore për kokë viçi, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 3vjet. Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, kohëzgjatja e qirasë duhet të jetë së paku 5 vjet.

***Sqarim- Dokumente përkatëse:** Të dëshmohet përmes vërtetimit nga Regjistri për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve. Ky fakt verifikohet edhe gjatë kontrollit të parë në teren, para nënshkrimit të kontratës. Nëse në momentin e kontrollit në teren numri i kafshëve është më i vogël se ai i paraqitur në aplikacion i vetmi arsyetim i pranueshëm është therrja në thertore të licencuar ose dëshmia e veterinarit të zonës se kafsha ka ngordhur.

3.4. Sektori i qumështit

- Aplikuesit për investime në sektorin e prodhimit të qumështit, në momentin e aplikimit nuk janë të obliguar të kenë kafshë , por në fund të investimit duhet të kenë së paku 10 mështjerra ose lopë qumështore ose 100 dele ose 100 dhi, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve (RRIK) në AUV. Kjo dispozitë nuk vlen për pikat grumbulluese.
- Aplikuesit që në momentin e aplikimit kanë kafshë, duhet të sjellin dëshmi nga Regjistri për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve për kafshët ekzistuese ashtu që të marrin pikë gjatë vlerësimit.
- Aplikuesit që në momentin e aplikimit nuk kanë asnje lopë, janë të detyruar që në fund të investimit të kenë së paku 10 mështjerra të matrikuluara dhe të regjistruara në RRIK në emër të përfituesit të grantit.
- Pikat grumbulluese duhet të kenë kontrata afatgjate (së paku njëvjeçare) me së paku 5 fermerë të cilët bashkërisht mbarështojnë së paku 30 lopë qumështore.
- Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).

  Në rast të investimeve në mekanizim bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë të paktën 0.5 hektar të tokës bujqësore për çdo krerë lope, respektivisht 0.05 hektar të tokës bujqësore për kokë deleje/dhie, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 5 vjet.

3.5. Sektori i rrushit

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë se kanë tokë bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, dhe atë së paku 0.3 hektar. Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.1 hektar.
- Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektarë me vreshta, në pronësi, të

trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës.

3.6. Sektori i vezëve

Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 5,000 pulave vojse në prodhimtari aktive.

Aplikuesit që aplikojnë për ndërtimin e fermës së pulave, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).

4. INVESTIMET E PRANUESHME

Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve të Pranueshme për Masën 101, e paraqitur si Shtojcë nr. 6 e Udhëzuesit për Aplikues.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është 3,000 €.

- Vlera maksimale e shpenzimeve te pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100.000 €.

Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim të stallave apo depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, këshilltarë të certifikuar apo kompani të licensuara për këshillime si dhe leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

4.1. INVESTIMET E PRANUESHME PËR SEKTORË

4.1.1. Investimet në sektorin e pemëve

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 1 hektar;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në prodhimin e energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit për pemët dru-frutore;
- Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.

4.1.2. Investimet në sektorin e perimeve dhe serrave (përfshirë patatet) dhe për depo

- Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për perime, pemë manore apo fidanë. Sipërfaqja minimale e një serre është 0.1 hektar;
- Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet burimeve të ripërtërishme;
- Blerja dhe instalimi i pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra;
- Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Ndërtimi i objekteve për trajtim pas vjeljes (klasifikim, paketim, etiketim) dhe për ruajtje të prodhimit, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.
- Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë.)

4.1.3. Investimet në sektorin e mishit

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme);
- Investimet në prodhim të energjisë e në fermë nga të gjitha llojet burimeve të ripërtërishme;
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;

4.1.4. Investimet në sektorin e qumështit

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse si dhe objekteve të qendrave grumbulluese të qumështit (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit, mjeltore) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh.. instalimi i ujit, i rrymës);
- Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje, si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit, përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat;
- Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
- Pajisje dhe makineri për heqjen e plehut
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

4.1.5. Investimet në sektorin e rrushit

- Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, zëvendësim) për rrush të tryezës dhe rrush të verës me madhësi minimale 0.3 hektar;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në vendosjen e plasmasit për rrush të tryezës;
- Investimet në prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe në rrethoja;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Atyre që kanë mbi 3 hektarë sipërfaqe me vreshta u lejohet edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;

4.1.6. Investimet në sektorin e vezëve

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave dhe dhomave për ruajtjen e vezëve;
- Investimet në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujë-pirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve)
- Investimet në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së;
- Ndërtimi dhe renovimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, trajtim, paketim dhe ruajtje të vezëve;
- Investimet në pajisje për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik dhe deponimin e tij.
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;

5. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR NËNSEKTORË

Tabela 1: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e pemëve

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritet. Në rast të investimit në infrastrukturë të pemishtes, depo, ujitje, mbrojtje kundër breshëri dhe / ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese* apo asaj që do të ngritët, cila do qoftë më e madhe.	≥ 3 ha	**50**
		≥ 1 ha - < 3 ha	45
2	Vlera e investimeve të pranueshme	≤ 50.000	**10**
		> 50.000	**8**

3	Cilësia e materialit fidanor	Investimi në fidanë të prodhuar dhe të certifikuar në një shtet anëtar të BE-së	**5**
4	Marrëdhëniet kontraktuese	Kontrata e për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës *(nuk u kërkohet aplikuesve për ngritje të pemishteve të reja nëse nuk kanë pemishte ekzistuese, ata i marrin 5 pikë nga ky kriter)*	**5**
5	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik *Ky kriter nuk zbatohet kur investimi bëhet në sipërfaqe të mbuluara nga sistemi i ujitjes dhe aplikuesi i merr pikët***	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme *(min. 5% e investimit të pranueshëm).*	**5**
6	Krijimi i vendeve të reja të punës	Llogaritet në bazë të tabelës në shtojcën nr. 17	Max. **8**
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit	10
8	Mbikqyrja profesionale	Aplikuesi deklaron se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar	5
9	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	**2**
GJITHSEJ			**100**

* Sipërfaqja ekzistuese të dëshmohet me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraprak ose ose nëse nuk ka marrë pagesa direkte dëshmohet me certifikatën e pronës dhe NIF-in.
** Nëse aplikuesi deklaron në planin e biznesit se toka në të cilën planifikohet investimi është nën sistemin e ujitjes, ai ka të drejt të investoj në energji të ripërtërishme, por nuk është i obliguar. Pavarësisht a ka investuar apo jo në energji të ripërtërishme ai i merr 5 pikë për këtë kriter. Ekzistimi i sistemit të ujitjes verifikohet me rastin e kontrollës së parë në terren.

Tabela 2: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e perimeve dhe serrave (përfshirë patatet)

Nr	**Lloji i kritereve**	**Kriteri/Kategoria**		**Pikët**
1	Kapaciteti prodhues	**Për serra**	**Për depo**	
		mbi 20 ari	Sipërfaqja me pemë dhe/ose perime duke përfshirë ato ekzistuese dhe ato që do të mbillen është më e madhe se 3 ha*	50
		10 deri 20 ari	Sipërfaqja me pemë dhe/ose perime duke përfshirë ato ekzistuese dhe ato që do të mbillen është më e vogël se 3 ha*	45
2	Vlera e investimeve të pranueshme	≤ 50.000		**10**
		> 50.000		**8**
3	Marrëdhëniet kontraktuese	Kontrata e për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës		10
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme *(min. 5% e investimit të pranueshëm)*		5
5	Krijim i vendeve të reja të punës	Llogaritet në bazë të tabelës në shtojcën nr. 17		Max. 8

6	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit	10
7	Mbikqyrja profesionale	Aplikuesi deklaron se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar	5
8	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ			**100**

* Sipërfaqja ekzistuese të dëshmohet me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraprak ose nëse nuk ka marrë pagesa direkte dëshmohet me certifikaten e pronës dhe NIF-in.

Tabela 3: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e mishit

Nr	**Lloji i kritereve**	**Kriteri/Kategoria**		**Pikët**
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 30 pikë)	a) Ndërtimi /rinovimi /zgjerimi i stallës (gropa septike është e detyrueshme për viça dhe derra**)		30
		b) Makineri dhe / ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme (depo e plehut, depo e silazhit, depo e sanës)		25
2	Vlera e investimeve të pranueshme	≤ 50.000		10
		> 50.000		8
3	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit	Viça	Derra	
		≥ 20 < 70 krerë	≥ 40 < 100 krerë	20
		≥ 70 krerë	≥ 100 krerë	15
4	Përvoja në prodhimin përkatës: aplikuesi ka gjedhe/derra në prodhim*	Aplikuesi ka së paku 5 krerë	Aplikuesi ka së paku 10 krerë	5
5	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata e për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës		5
6	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme *(min. 5% e investimit të pranueshëm)*		5
7	Punësimi	Llogaritet në bazë të tabelës në shtojcën nr. 17		Max. 8
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit		10
9	Mbikqyrja profesionale	Aplikuesi deklaron se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar		5
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër		2
	GJITHSEJ			**100**

* Të dëshmohet përmes vërtetimit nga Regjistri për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve. Ky fakt verifikohet edhe gjatë kontrollit të parë në teren, para nënshkrimit të kontratës. Nëse në momentin e kontrollit në teren numri i kafshëve është më i vogël se ai i paraqitur në aplikacion i vetmi arsyetim i pranueshëm është therrja në thertore të licencuar ose dëshmia e veterinarit të zonës se kafsha ka ngordhur.
** Gropa septike bën pjesë në infrastrukturë të stallës dhe investimet për gropë septike llogariten në pjesën e infrastrukturës dhe mekanizimit.

Tabela 4: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e qumështit

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria			Pikët
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 35 pikë)	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallës apo pikës grumbulluese të qumështit			35
		b) Makineri dhe / ose përmirësimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme (depo e plehut, depo e silazhit, depo e sanës)			30
2	Vlera e investimeve të pranueshme	≤ 50.000			10
		> 50.000			8
3	Kapaciteti prodhues: numri i kafshëve në prodhimtari aktive para aplikimit ose numri i fermerëve të kontraktuar për pika grumbulluese	Lopë qumështore	Dele/Dhi qumështore	Pikat grumbulluese	
		≥ 5 < 10 krerë	≥ 50 < 100 krerë	≥ 5 < 10 fermerë	5
		≥ 10 krerë	≥ 100 krerë	≥ 10 < 20 fermerë	10
4	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata njëvjeçare* për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës			5
5	Mënyra e mbajtjes pas përfundimit të investimit. Ky kriter vlen vetëm për lopë qumështore. Të tjerët i marrin 10 pikë.	Sistemi i lirë i mbajtjes			10
		Sistemi i lidhur i mbajtjes			5
6	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme *(min. 5% e investimit të pranueshëm)*			5
7	Punësimi	Llogaritet në bazë të tabelës në shtojcën nr. 17			Max. 8
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit			10
9	Mbikqyrja profesionale	Aplikuesi deklaron se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar			5
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër			2
GJITHSEJ					**100**

*Kontrata njëvjeçare nënkupton kontratën për vitin e aplikimit.

Tabela 5: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e rrushit

Nr	Lloji i kritereve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritet. Në rast të investimit për depo dhe / ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese apo asaj që do të ngritet, cilado qoftë më e madhe.	≥ 3 ha	55
		≥ 1 ha - < 3 ha	50
		≥ 0.30 ha - < 1 ha	45
2	Vlera e investimeve të pranueshme	≤ 50.000	10
		> 50.000	8

3	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës *(nuk u kërkohet aplikuesve për ngritje të vreshtave të reja nëse nuk kanë vreshta ekzistuese, ata i marrin 10 pikë nga ky kriter)*	5
4	Punësimi	Llogaritet në bazë të tabelës në shtojcën nr. 17	Max. 8
5	Vendi i investimit	Komuna: Rahovec, Suharekë, Prizren, Gjakovë, Malishevë, Mamushe, Peja, Istog dhe Kline.	5
6	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit	10
7	Mbikqyrja profesionale	Aplikuesi deklaron se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar	5
8	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ			**100**

Tabela 6: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e vezëve

Nr	**Lloji i kritereve**	**Kriteri/Kategoria**	**Pikët**
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit të kombinuar, pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 25 pikë)	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallës	25
		b) Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të fermës; ndërtimi i depove për ushqim; trajtimi i plehut organik; dhomë për ruajtje të vezëve; Makineri dhe pajisje bujqësore	20
2	Kapaciteti prodhues: numri i pulave vojse në prodhimtari aktive para aplikimit	≥ 5,000 - < 25,000 pula vojse	15
		≥ 25,000	10
3	Mënyra e mbajtjes së pulave	Sistemi i lirë, në natyrë	15
		Sistemi i lirë, në dysheme	10
		Në kafaz, sipas standardeve të BE-së	5
4	Vlera e investimeve të pranueshme	≤ 50.000	10
		> 50.000	8
5	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	5
6	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (*min. 5% e investimit të pranueshëm*)	5
7	Punësimi	do të llogaritet në bazë të tabelës në shtojcën nr. 17	Max. 8
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit	10
9	Mbikqyrja profesionale	Aplikuesi deklaron se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar	5
10	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ			**100**

Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njejtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

6. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është 3,000 €.
- Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit.
- Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore dhe 5% për fermerë të rinj (40 vjeç ose më të rinj në momentin e aplikimit).
- Përkrahja maksimale publike për periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për Masën 101 është 400,000 € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikoj me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartëpërmendur.

7. INDIKATORËT E PROGRAMIT

Tabela 7: Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	**Treguesi**		**Caku për 2018**
Inputi	Gjithsej:		12,000,000
	101.1. Sektori i pemëve		2,500,000
	101.2. Sektori i perimeve dhe serrave (përfshirë patatet)		3,500.000
	101.3. Sektori i mishit		2,300,000
	101.4. Sektori i qumështit		2,900,000
	101.5. Sektori i rrushit		500,000
	101.6. Sektori i vezëve		300,000
Outputi	Numri i përgjithshëm i fermave të përkrahura		387
	Prej të cilave	101.1. Sektori i pemëve	75
		101.2. Sektori i perimeve dhe serrave	125
		101.3. Sektori i mishit	70
		101.4. Sektori i qumështit	78
		101.5. Sektori i rrushit	32
		101.6. Sektori i vezëve	7
	Vlera e investimeve (€)		17,823,000
	Prej të cilave	101.1 Sektori i pemëve	3,712,500
		101.2. Sektori i perimeve dhe serrave përfshirë patatet	5,197,500
		101.3. Sektori i mishit	3,415,500
		101.4. Sektori i qumështit	4,306,500
		101.5. Sektori i rrushit	745,500

		101.6. Sektori i vezëve		445,500
Rezultati	Numri i përgjithshëm i fermave me kapacitet të zgjeruar			311
	Numri i përgjithshëm i fermave të modernizuara që kanë aplikuar pajisje dhe/ose teknologji të re			349
	Rritja e madhësisë së fermave të përkrahura	Nr. i hektarëve të shtuar me pemë drufrutore		148
		Numri i m² me serra të reja		237,566
		Numri i hektarëve të shtuar me rrush		27
		Numri i kafshëve të shtuara	Lopë qumështore	520
			Pula vojse	26,471
			Gjedhe për majmëri	854
			Derra për majmëri	323
	Numri i pikave të përkrahura grumbulluese të qumështit			12
	Depo të reja të pemëve dhe perimeve (tonë/vit)			6,500
	Numri i fermave që kanë investuar në aktivitetet pas vjeljes (paketim, klasifikim, etiketim etj.)			82
	Numri i fermave që kanë ndërtuar depot e plehut			44
	Numri i fermave që prodhojnë energji të ripërtërishme			366
**Ndikimi	Të hyra shtesë (€/vit)			10,341,000
	Vende të reja të punës me orar të plotë			1076
	Rritja e produktivitetit të punës, si rritje (në%) e të hyrave shtesë, bruto për çdo vend pune, në fermat e përkrahura			15%

**Caqet janë vendosur në bazë të buxhetit të parashikuar, prandaj çdo ndryshim i buxhetit do të reflektohet proporcionalisht në indikatorë.*

***Vlerësimi të bëhet nga vlerësues të pavarur*

8. PROCEDURA ADMINISTRATIVE

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ, i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

9. AFATI I ZBATIMIT

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 90 ditë kalendarike, përveç për projekte që parashohin ndërtim të stallës apo të depos me ç'rast afati i zbatimit është 120 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas afatit të zbatimit, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë.

AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit maksimalisht për 30 ditë duke lidhur një aneks-kontratë në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke e arsyetuar zgjatjen e afatit me argumente

të qëndrueshme, siç është respektimi i periudhave vegjetative te bimët, moti i papërshtatshëm për kryerjen e punëve ndërtimore, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër, etj.

10. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10.1. Rregullat për shpenzimet e pranueshme

Paratë e grantit mund të merren vetëm pasi përfituesi ka realizuar investimin dhe ka paguar faturat në përputhje me aplikacionin e tij dhe kontratën të cilën e ka nënshkruar me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (shih shtojca nr. 6, listën e investimeve të pranueshme). Shpenzimet janë të pranueshme vetëm nëse ato ndodhin pas nënshkrimit të Kontratës në mes të aplikuesit dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me përjashtim të shpenzimeve administrative, të cilat mund të ndodhin para nënshkrimit të kontratës, por ato u pranohen vetëm aplikuesve të përzgjedhur.

Shpenzimet administrative siç janë: pagesat për arkitekt, inxhinierë, si dhe pagesat për konsultime, për studime fizibiliteti, përvetësim i të drejtave patentore dhe licencave. Shuma maksimale e pranueshme për këto shpenzime nuk duhet të tejkaloj 10% të shpenzimeve të pranueshme, prej të cilave shpenzimet për përgatitjen e projekt-propozimeve dhe planeve të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 3% të shpenzimeve të pranueshme.

Këto shpenzime janë të pranueshme në mënyre retroaktive vetëm për përfituesit përfundimtarë.

Projekt-propozimi dhe plani i biznesit mund të përgatiten edhe nga vetë aplikuesi. Kur ato përgatiten nga një kompani konsulente, kostoja e tyre duhet të futet në tabelën e shpenzimeve të pranueshme.

10.2. Shpenzimet e papranueshme

Të papranueshme janë shpenzimet e paraqitura më poshtë:

- Shpenzimet e bëra para nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç shpenzimeve administrative;
- Tatimet, përfshirë TVSH-në, përpos për persona fizik dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së;
- Taksat doganore dhe të importit ose ndalesat tjera;
- Blerja, marrja me qira e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e gjyqit;
- Shpenzimet operative (shpenzimet për zhvillimin e aktivitetit);
- Pajisjet e përdorura;
- Makineritë dhe pajisjet pa numër serik dhe të dhëna teknike;
- Ndalesat bankare, shpenzimet e garantimit dhe ndalesat e ngjashme;
- Shpenzimet e konvertimit, ndalesat dhe humbjet nga ndërrimi i valutës;
- Kontributet në natyrë;

- Blerja e të drejtave për prodhimtari bujqësore, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- Çfarëdo shpenzimi për mirëmbajtje, zhvlerësim apo qira;
- Çfarëdo shpenzimi nga administrata publike në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës;
- Shpenzimet e sigurimit;

Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre. Për shpenzimet e papranueshme nuk është e nevojshme të respektohen procedurat e prokurimit.

TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje joraportuese të TVSH-së. Për ndërmarrjet raportuese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm! Në këtë adresë të internetit:

http://apps.atk-ks.org/BizPasiveApp/VatRegist/SearchVat mund të shkarkohen raportet me të cilat mund të vërtetohet nëse biznesi është raportues apo jo i TVSH-së.

Çdo tentim për mashtrim (psh. falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mospagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

Promovimi i përkrahjes

Të gjithë përfituesit duhet t'i respektojnë rregullat e promovimit të përcaktuara nga institucioni financues. Të gjithë përfituesit e granteve nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, para kërkesës për pagesën e fundit, në vendin e investimit, duhet të vendosin një tabelë siç është paraqitur në Shtojcën nr. 15. Kjo tabelë duhet të vendoset në vend të dukshëm, me madhësi: 100 cm x 50 cm, e punuar nga plastikë e fortë, e shkruar me ngjyrë të qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike.

11. PROCEDURAT E APLIKIMIT

11.1. Përmbajta e aplikacionit

Aplikacioni duhet të përmbajë të gjitha dokumentet, të radhitura sipas Listës së dokumenteve të paraqitur në Shtojcën nr. 1. dhe të dorëzohet në afatin për aplikim. Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e kopjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që një kopje të dosjes ta ruajnë për nevoja personale.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm, zyrtari i AZHB-së në Zyre Regjionale nuk e pranon aplikacionin. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i kompletoj dokumentet. **Këshillohen aplikuesit që të aplikojnë së paku 5 ditë para përfundimit të afatit për aplikim, ashtu që të kenë mundësi të kompletojnë dokumentacionin e tyre në rast të mungesës së ndonjë dokumenti.**

Në rastet kur kërkohen kopje të dokumenteve, dokumentet në origjinal duhet t'u prezantohen zyrtarëve të Agjencisësë Zhvillimit të Bujqësisë. Aplikuesi duhet të shkruajë në kopje këtë tekst*: "si në origjinal"* dhe të nënshkruaj.

11.2. Dorëzimi i aplikacioneve dhe afati i fundit

Thirrja për Aplikim bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe njoftimi do të publikohet në faqen e internetit të MBPZHR: www.mbpzhr-ks.net dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë www.azhb-ks.net.

AZHB planifikon që të shpallë thirrjet për aplikim në çerekun e parë të vitit. Ftohen të interesuarit që ta vizitojnë uebfaqen e AZHB-së së paku njëherë në javë.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në Zyret Ragjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, (shih shtojcën nr. 11, me adresat e tyre)

11.3. Vlerësimi, përzgjedhja, kontraktimi dhe implementimi

AZHB përdor listën e kontrollimit të aplikuesve dhe projekteve dhe verifikon të dhënat me sistemet zyrtare (Regjistrin e fermës dhe Regjistrin për identifikim të kafshëve).

11.4. Vlerësimi i planit të biznesit ose i projekt-propozimit

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme mbi 20,000 € duhet të përmbajnë një plan të biznesit, sipas modelit të paraqitur në shtojcën nr. 3.

Aplikacionet me vlerë të investimeve të pranueshme deri në 20,000 € duhet të përmbajnë një projekt-propozim sipas modelit të paraqitur në shtojcën nr. 2.

Nëse aplikacioni parasheh plan biznes, atëherë nuk ka nevojë të ketë projekt-propozim.

Disa informata që përfshihen në planin e biznesit ose në projekt-propozim, duhet të merren parasysh për poentimin e aplikacioneve. Gjithashtu, këto dokumente paraqesin burimin e të dhënave për plotësimin e formularit për indikator.

Të dhënat/informatat e paraqitura brenda këtyre dokumenteve duhet të kontrollohen në të gjitha bazat e të dhënave ekzistuese (Regjistrin e fermës, regjistrin për identifikimin e kafshëve, regjistrin kadastral të vreshtave, sLPIS etj.), duhet të mbështeten me dokumentet shtesë – shih shtojcën nr. 1, dhe duhet të jetë subjekt kontrollimi në terren para se kontrata të nënshkruhet, para pagesës së mjeteve financiare dhe pasi që projekti është përfunduar, gjatë periudhës së monitorimeve ex-post.

Plani i biznesit ose projekt-propozimi duhet ta respektojnë plotësisht modelin e përgatitur nga MBPZHR. Të gjithë kapitujt duhet të trajtohen; mostrajtimi i ndonjë kapitulli është arsye e mjaftueshme për refuzimin të aplikacionit. Paraqitja e kapitujve shtesë do të injorohet gjatë vlerësimit të projektit.

Përmbajtjet e mëposhtme janë pjesë e vlerësimit të planit të biznesit:

1. Të gjithë kapitujt dhe nënkapitujt janë trajtuar; nëse nuk është relevante për aplikuesin atëherë duhet sqaruar arsyeja;
2. Është përmbushur së paku 1 (një) objektivë specifike e masës;
3. Projekti është në përputhje me potencialin e zonës;
4. Kthimi i investimeve dëshmon që fitimi shtesë (të hyra shtesë – kosto shtesë) mbulon kostot e investimeve (të llogaritet vetëm bashkëfinancimi privat) për më pak se 10 vjet;
5. Vlerësohet se aplikuesika mjaft staf (të punësuar) për të funksionuar biznesi;
6. Blerjet/ndërtimet e propozuara janë në pajtim me nevojate aplikuesit (psh. jo më shumë traktorë, rimorkio, apo makina sesa ka nevojë; nuk lejohen ndërtesa nëse aplikuesi ka mjaft);
7. Blerjet/ndërtimet e propozuara janë në përputhje me procesin e aplikuar teknologjik;
8. Çmimet për blerjet/ndërtimet janë të arsyeshme;
9. Orari për blerjet/ndërtimet është real dhe jep mundësinë që investimi të përfundojënë afatin e implementimit të paraparë me këtë udhëzues.
10. Është paraqitur kapaciteti i prodhimit para dhe pas investimit;
11. Rritja e paraparë e kapacitetit prodhues është plotësisht e dëshmuar bazuar në investimin e propozuar;
12. Është përshkruar procesi teknologjik dhe teknologjia e zbatuar;
13. Procesi teknologjik është në përputhje me asetet ekzistuese + investimet e parapara dhe shërbimet e ofruara.
14. Furnizuesit potencial dhe klientët potencial janë identifikuar (e dëshmuar përmes kontratave dhe parakontratave);
15. Strategjia e tregut është reale;
16. Për të gjitha investimet e pranueshme dhe të papranueshme janë paraqitur saktë vlerat e ndihmës publike dhe financimit privat;

17. Bilanci i rrjedhjes së parasë, në fund të çdo muaji, duhet të jetë pozitiv në 3 vitet e ardhshme pas përfundimit të investimit;
18. Shpenzimet e parapara përfshijnë: koston shtesë nga fuqia punëtore shtesë (pagat dhe kontributet), energji e konsumuar shtesë, pagesat për furnizuesit e rinj, ofruesit e shërbimeve, kthimi i huas, etj.;
19. Të hyrat e parapara shtesë janë në përputhje me kapacitetin prodhues;
20. Të hyrat e parapara shtesë janë në përputhje me strategjinë e marketingut (psh. është e pamundur që një sasi e madhe e perimeve të shpërndahet direkt nga përfituesi në tregun e gjelbër);
21. Të hyrat shtesë në llogaritjen e kthimit të investimit janë në përputhje meprodhimin shtesë të paraqitur në indikatorët e ndikimit.
22. Aplikuesi nuk ka krijuar kushte artificiale për të përfituar përparësi.

- Për projekt-propozimet janë të zbatueshme kontrollet nr: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 16 dhe 22.

11.5. Kontrollet në terren

Do të kryhen së paku 3 kontrolle në teren:

1. Kontrolli i Parë (kontrolli para miratimit),

2. Kontrolli i Dytë (kontrolli pas investimit e para pagesës),
3. Ex-post Kontrolli (Monitorimi) dhe Superkontrolli,
4. Rikontrolli.

Kontrolli i Parë (kontrolli para miratimit), realizohet pas procesit të vlersimit dhe përfshinë
- kontrollin e aseteve te deklaruara në Planin e Biznesit nga aplikues,
- verifikimin e parcellave katastrale,
- verifikimin e numrit të kafshëve, shpezëve etj. dhe
- verifikimin e pikave kyçe për të cilat është poentuar aplikacioni.

Ç'do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit dhe do të ndikoj në procesin e Miratimit të aplikacionit.

Kontrolli i Dytë (kontrolli pas investimit e para pagesës), realizohet pas kryerjes së investimeve sipas kontratës dhe paraqitjes së pakos së kërkesës për pagesë nga përfituesi dhe përfshinë:
- kontrollin e secilit pozicion investues sipas tabës për investimet e parapara, Letrës së Informimit dhe kontratës së nënshkruar,
- verifikimin e cilësisë së investimit,
- verifikimin e numrit të kafshëve, shpezëve etj. dhe
- verifikimin e realizimit të standardeve minimale nacionale.

Ç'do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Kontrollit të Dytë dhe do të ndikoj në procesin e Autorizimit të pagesave.

Ex-post Kontrolli (Monitorimi), është proces i monitorimit të projetit të bashkfinancuar nga MBPZHR-AZHB dhe përfituesit, sipas obligimeve të marrura me kontratë, për periudhën 5 vjeçare dhe përfshinë:
- verifikimin e të gjitha pozicioneve investuese, dhe
- verifikimin e funksionalitetit të projektit dhe mirmbajtja e investimeve.

Ç'do mospërputhje do të regjistrohet në Raportin e Ex-post kontrollit dhe do ti drejtohet zyrës ligjore për procedim të mëtutjeshëm.
Superkontrolli, është kontroll i veçant që organizohet me vendim të zyrtarëve siprorë ka ka për qëllim :
- verifikimin e investimeve të kryera në teren,
- pengimin e manipulimeve dhe mashtrimit, dhe
- vlersimin e punës së inspektoratit.

Rikontrolli, është kontroll që organizohet vetëm në raste të caktuara dhe me kërkesë të drejtorive përkatëse (Drejtorisë së Miratimit të Projekteve dhe Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave).

KUJDES: Kur kërkohet të kontrollohet, përfituesit janë të obliguar të lejojnë qasje të lirë dhe të menjëhershme në ndërmarrje, në pajisjet e ndërmarrjes dhe ndonjë dokument të kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Nëse ndodhë mosrespektimi i këtij kushti, duhet të bëhet kthimi i menjëhershëm i përkrahjes publike dhe do të aplikohet ndëshkimi i përfituesit.

11.6. Radhitja në listë

Të gjitha projektet që kanë kaluar kriteret e pranueshmërisë, pas vlerësimit, duhet të radhiten në listë në bazë të pikëve të fituara dhe eventualisht kohës së aplikimit. Përzgjedhja e përfituesve bëhet duke filluar nga aplikuesi me numrin më të madh të pikëve dhe vazhdon deri sa të shpenzohet buxheti i paraparë.

11.7. Procedurat e dhënies së grantit dhe njoftimi i aplikuesit

Pas vlerësimit, AZHB përgatit raportin e vlerësimit. Projektet klasifikohen në këtë raport në:

1) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë)
dhe
2) projekte të pranueshme dhe të vlerësuara me pikë.

Ky raport nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB-së.
Pas kontrollës administrative dhe vlerësimit, AZHB përgatit Raportin preliminar të publikimit i cili krahas publikimit në uebfaqe të AZHB-së, aplikuesit i dërgohet informatë me sms dhe email. Aplikuesit të cilët nuk e pranojnë informatën përmes sms-it dhe email-it mund të vijnë në AZHB për informata lidhur me aplikacionin e tyre. Raporti përfshinë 1) projekte të pranueshme, të vlerësuara dhe të shpallura përfitues potencial, 2) projekte të pranueshme dhe të vlersuara në pritje dhe 3) projekte të papranueshme (që nuk e kanë kaluar kriterin e pranueshmërisë -refuzuara). Raporti preleminar, nënshkruhet nga Kryeshefi i AZHB-së dhe publikohet në ueb faqe të AZHB-së dhe ueb faqe të MBPZHR-së. Prej ditës së publikimit të raportit preliminar në ueb faqe të AZHB-së, aplikuesi ka afat 15 ditë (kalendarike) të ushtroj ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në AZHB.

11.8. Kontrata mes përfituesit dhe AZHB-së, bashkë me procedurat e prokurimit

Të gjithë përfituesit do të nënshkruajnë një kontratë standarde – shih shtojcën nr.4.

Lista e përfituesve që nënshkruajnë kontratë do të publikohet nga AZHB-ja.
Plani i biznesit ose projekt propozimit së bashku me të gjitha dokumentet e paraqitura bëhet pjesë e kontratës. Kontrata mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët (AZHB dhe përfituesi) deri në përfundim të periudhës monitoruese, që është 5 vjet pas implementimit të projektit.

Nëse perfituesi potencial ka qenë paraprakisht përfitues i ndonjë projekti nga MBPZHR-ja në 5 vitet e fundit dhe ndodhet në periudhën monitoruese, para nënshkrimit të kontratës së re me AZHB-në duhet të bëhet një kontroll në mënyrë që të bëhet verifikimi i projektit të mëparshëm a është mirëmbajtur dhe a është funksional. Jetëgjatësia e kontratës mbetet në fuqi nga momenti i nënshkrimit nga të dyja Palët (Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe përfituesit) deri në përfundimin e periudhës monitoruese që është 5 vjet pas zbatimit të projektit.

Periudha e përfundimit të projektit nënkupton përfundimin e investimit. Kontrata e mbulon edhe periudhën e monitorimit.

Kujdes: Në rast se përfituesi tërhiqet nga implementimi i projektit pas nënshkrimit të kontratës, duke e njoftuar AZHB-në, ai e humb të drejtën e aplikimit për vitin vijues.

Përfituesit që pas nënshkrimit të kontratës nuk e implementojne projektin dhe nuk lajmërohen në AZHB për tu tërhequr, humbin te drejtën e aplikimit per tri vitet e ardhshme.

Pas nënshkrimit të kontratës dhe realizimit të investimit, përfituesi duhet të kërkojë pagesën e shpenzimeve të pranueshme, në përputhje me intensitetin e ndihmës publike, duke plotësuar formularin e ofruar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, shih shtojcën nr. 8. të kërkesës për pagesë. Përfituesi duhet t'ia bashkëngjes dëshmitë e pagesës (faturat dhe kuponin fiskal ose transferin bankar për pagesat nën 500 euro kurse për pagesat me vlerë 500 e më shumë euro, faturat dhe transferin bankar) , si dhe provat e kryerjes së procedurave të prokurimit nëse një gjë e tillë është e paraparë me kontratë. Aprovimi i pagesës do të realizohet pas kontrollimit të dokumenteve dhe pas kontrollit në terren të kryer nga zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë. E tërë dosja e kërkesës për pagesë duhet të skanohet në CD dhe të dorëzohet bashkë me kërkesën për pagesë në AZHB.

Kujdes: në rast se përfituesi është person juridik, llogaria në të cilën do të kryhet pagesa nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë duhet të jetë e personit juridik dhe jo në emër të pronarit. Gjithashtu, në rast se përfituesi është femër, llogaria bankare duhet t'i përket asaj, e jo anëtarëve tjerë të familjes së tyre dhe anasjelltas.

11.9. Monitorimi Ex-post

Të gjitha projektet do të monitorohen 5 vjet pas implementimit të projektit. Kontrollimi do të bëhet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Qëllimi i investimit duhet të ruhet edhe 5 vjet pas investimit. Gjithashtu, përfituesit duhet të vazhdojnë t'i respektojnë të gjitha kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes për të cilat aplikuesit janë poentuar. Nëse ndodh shkelja e këtyre rregullave, atëherë do të kthehet granti dhe përfituesi do të ndëshkohet me pagesë.

Aplikacionet duhet të refuzohen nëse nuk janë të kompletuara, nëse nuk e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë ose/edhe kur e plotësojnë kriterin e pranueshmërisë mund të mos përfitojnë për shkak të numrit të vogël të pikëve në krahasim me aplikuesit e tjerë dhe buxhetit të paraparë.

Aplikacionet e pakompletuara refuzohen në momentin e verifikimit nga zyrtari i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, me rastin e dorëzimit të tyre. Në rast se konstatohet më vonë se aplikacioni nuk është i kompletuar, ai poashtu refuzohet.

Aplikacionet e papranueshme – deklarohen të papranueshme gjatë procesit të vlerësimit të cilin e bëjnë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë. Projektet mund të deklarohen si të papranueshme gjatë kontrollit administrativ (psh. mospërputhje me të dhënat nga Regjistri i Fermës apo Regjistri për Identifikimin e Kafshëve), gjatë vlerësimit të dokumenteve (psh. vlerësimi i Planit të Biznesit) ose gjatë kontrollit në terren (psh. pemishtja ose serra ka qenë e ngritur më herët). Projektet e papranueshme nuk i nënshtrohen procesit të dhënies së pikëve.

12. LISTA E SHTOJCAVE

1. Shtojca nr. 1: Formulari i aplikimit për Masën 101
2. Shtojca nr. 2: Lista e dokumenteve të dorëzuara
3. Shtojca nr. 3: Modeli për Përgatitjen e Projekt-Propozimit
4. Shtojca nr. 4: Modeli për përgatitjen e planit të biznesit
5. Shtojca nr. 5: Kontrata e AZHB-së me përfitues me procedurat e prokurimit
6. Shtojca nr. 6: Standardet minimale kombëtare
7. Shtojca nr. 7: Lista e investimeve të pranueshme për Masën 101
8. Shtojca nr. 8: Zonat malore
9. Shtojca nr. 9: Kërkesa për pagesë
10. Shtojca nr. 10: Raporti i Vlerësimit
11. Shtojca nr. 11: Forma e ankesës për fermerë
12. Shtojca nr. 12: Kontaktet dhe vendet informuese për aplikim
13. Shtojca nr. 13: Formularët për mbledhjen e indikatorëve për M-101
14. Shtojca nr. 14: Pjesa financiare e planit të biznesit
15. Shtojca nr. 15: Promovimi
16. Shtojca nr. 16: Kodi i etikës për kompanitë këshilluese
17. Shtojca nr. 17: Numri i vendeve të punës
18. Shtojca nr. 18: Kushtet specifike për ndërtimin e serrave
19. Shtojca nr. 19: Deklarata nën betim

Shtojca nr. 1 Formulari i aplikimit për masën 101

<table>
<tr><td colspan="2">FORMULARI PËR APLIKIM-2018

MASA 101, INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË EKONOMITË BUJQËSORE, SEKTORI I PEMËVE, PERIMEVE (PËRFSHIRË PATATET) SEKTORI I RRUSHIT, SEKTORI I QUMËSHTIT, SEKTORI I MISHIT DHE SEKTORI I VEZËVE</td></tr>
<tr><td rowspan="7">I. Emri i Aplikuesit</td><td>……
(Emri, emri i babës, mbiemri ose subjekti juridik)</td></tr>
<tr><td>Numri Personal
Nr. Letërnjoftimit</td></tr>
<tr><td>Komuna:</td></tr>
<tr><td>Vendbanimi:</td></tr>
<tr><td>Adresa:</td></tr>
<tr><td>Telefoni:</td></tr>
<tr><td>E-mail:</td></tr>
<tr><td>Ueb faqja:</td></tr>
</table>

	Statusi juridik: Person fizik ☐ Ndermarrje ☐
II. Emri i Projektit	_____ _____
Vetëm për përdorim zyrtar (të plotësohet nga zyrtari regjionali AZHB-së):	
Numri unik regjistrues i projektit (NUR):_____	
III. Data	_____ (dd/mm/vvvv)
IV. Koha	_____ (ora dhe minuta, të plotësohet vetëm kur aplikacioni të jetë kompletuar)
V. Aplikacioni është kompletuar	☐ **PO** ☐ **JO**

Nënshkrimi i aplikuesit .....

VI. Numri (NIF) nga Regjistri i Fermës:		
VII. Për ndermarrje Numri Regjistrues i Biznesit:		
VIII. Për të gjithë Aplikuesit:		
Banka	Emri i bankës:	
	IBAN:	
	Nr. Llogarisë rrjedhëse:	
	Adresa:	
Në rast se aplikimi bëhet përmes një personi të autorizuar:		
Emri _____ Emri i Babës_____ Mbiemri _____	Numri Personal Nr. i letërnjoftimit Email:_____	
VIII. Deklaratat		
Unë deklaroj se ☐ unë apo ndonje anëtar ekonomisë time familjare nuk kemi pranuar grant nga MPBRZH në 3 vitet e fundit ☐ unë apo ndonje anëtar ekonomisë time familjare kemi pranuar, grant nga MPBRZH në tri vitet e fundit.		
Unë deklaroj se para kerkeses per pagese do te ndjeke se paku 20 ore trajnime perkatese ☐ **Po** ☐ **Jo**, nuk do të ndjeke trajnime		
☐ **Po**, unë kam arsimim formal bujqësor dhe më shumë se 2 vjet përvojë relevante - siç dëshmojnë dokumentet nr. _____ dhe nr._____ të bashkangjitura ☐ **Jo**, unë nuk kam arsimim formal bujqësor dhe më shumë se 2 vjet përvojë relevante		
X. Zotimet		
Unë zotohem se do të siguroj shpenzimet e bashkë-financimit dhe ato të papranueshme të projektit.		

Unë zotohem se dotë siguroj burimine ujit-në rastin e projekteve të cilat parashohin investime në sistemet e ujitjes
Unë zotohem se do të vazhdoj veprimtarinë në fermë dhe do të ruaj qëllimin e investimeve të mbështetura për të paktën 5vjet pas implementimit të projektit
Të gjitha të dhënat, informatat dhe dokumentacioni, të cilin unë e kam paraqitur në këtë formular për aplikim janë të vërteta. Jam i vetëdijshëm se paraqitja e të dhënave të pavërteta ndëshkohet me ligjet e vendit. Nënshkrimi i aplikuesit _____

XI. Kalkulimi dhe përqindja e përkrahjes. Përqindja e përkrahjes është 60%

Përkrahje shtesë:

+ 5% nëse aplikuesi është fermer i ri (deri në moshën 40 vjeçare) në momentin e aplikimit

□ Jo, □ Po, nëse Po,

+ 5 % nëse investimi është vendosur në Zonat Malore

□ Jo, □ Po, emri i vendbanimit _____

XII. Tabela financiare e projektit (siç është paraqitur në planin e biznesit ose në projekt-propozim)

Investimet e pranueshme (€)	% e përkrahjes publike	Vlera e përkrahjes publike (€)	Financimi privat (€)

_____ _____

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i aplikuesit) (Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i zyrtarit regjional)

Data: _____

Shtojca nr. 2 Lista e dokumenteve të dorëzuara

Dokumentet e kompletuara (dosja) duhet t'i ketë dokumentet e radhitura si në listën e mëposhtme dhe çdo faqe duhet ta ketë të shkruar numrin (me dorë). Ky numër duhet të paraqitet në listë pranë emrit të dokumentit. Dosja e aplikacionit dorëzohet në dy kopje fizike dhe të gjitha dokumentet e dosjes fizike skanohen dhe ruhen në një CD e cila dorëzohet bashkë me kopjet fizike. Këshillohen aplikuesit që të një kopje të dosjes ta ruajnë për nevoja të veta.

Në rast të mungesës së ndonjë dokumenti të detyrueshëm, zyrtari i AZHB-së nuk e pranon aplikacionin, por e regjistron aplikuesin dhe i jep atij një kopje të kësaj shtojce, duke ia

rrumbullakuar dokumentet që i mungojnë aplikuesit. Aplikuesi ka afat deri në përfundim të thirrjes për aplikim që t'i kompletojë dokumentet. Në rastet kur kërkohet vetëm kopje e dokumentit, aplikuesi e shkruan me dorë në kopje "**sikur në origjinal**" dhe iasjell origjinalin në shikim zyrtarit rajonal i cili verifikon përputhshmërinë e kopjes dhe ia kthen origjinalin aplikuesit. **Këshillohen aplikuesit që të aplikojnë së paku 5 ditë para përfundimit të afatit për aplikim, ashtu që të kenë mundësi të kompletojnë dokumentacionin e tyre në rast të mungesës së ndonjë dokumenti.**

Nr.	Dokumenti	**obligativ**	**Opcional**
1.	**FORMULARI PËR APLIKIM** Të plotësohet me makinë ose me kompjuter. Kontrolli nëse dokumentet janë të mbushura si duhet do të bëhet në momentin e dorëzimit në prani të aplikuesit	**f.** _ ☐	
2.	**KOPJE E LETËRNJOFTIMIT** Zyrtari verifikon në prani të aplikuesit a është letërnjoftimi i lëshuar nga Republika e Kosovës dhe a është i vlefshëm në momentin e aplikimit.	**f.** _ ☐	
3.	**CERTIFIKATA E LINDJES,** kopje	**f.** ☐	
4.	**CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN E FERMËS (NIF)**	**f.**_ ☐	
5.	**FORMULARI PËR INDIKATOR** i plotësuar (në origjinal) Në prani të aplikuesit, zyrtari verifikon a është plotësuar si duhet formulari për indikatorët.	**f.** ☐	
6.	**LLOGARIA RRJEDHËSE**, dokument i lëshuar nga një bankë që operon në Kosovë.	**f.** _ ☐	
7.	Në rastin e personave juridik: **CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT**(kopje) dhe **CERTIFIKATA E NUMRIT FISKAL–** kopje	**f.** _ ☐ ☐	
8	**Në rastin e projekteve të ndërtimit/zgjerimit:** o Certifikata e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi; o Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit (Për tokat e marra me qira nga komunat dhe APK-ja kontratat nuk kanë nevojë të noterizohen; o Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi; o Kopjen e skicave të objektit; o Parallogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara; o Pëlqimin e Komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë leje ndërtimi; Në rastin e projekteve që parashohin renovim, aplikuesit, me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë: Parallogarinë e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;	**f.** _ ☐ **f.** _ ☐ **f.** _ ☐ **f.** _ ☐ **f.** _ ☐	

8.	**PLANI I BIZNESIT**- Në rastin e projekteve në vlerë mbi 20,000 € ose **PROJEKT-PROPOZIMI–** Në rast të projekteve me vlerë deri në 20,000 €. Zyrtari verifikon nëse këto dy dokumente janë në përputhje me modelin e AZHB-së.	**f.** _ ☐	
9.	Jo të gjitha dokumentet nën pikën 9 janë të obligueshme (për të dëshmuar përvojën dy vjeçare në sektor) **CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN E FERMËS** për të dëshmuar përvojën mbi dyvjeçare në bujqësi – kopje **ose** **VËRTETIM NGA PUNËDHËNËSI** se aplikuesi ka më shumë se dy vjet përvojë pune në bujqësi **ose** **DIPLOMA ose CERTIFIKATA E SHKOLLËS SË MESME BUJQËSORE-kopje e noterizuar** **DIPLOMA E FAKULTETIT TË BUJQËSISË**, Veterinarisë apo Teknologjisë së Ushqimit – kopje e noterizuar		**f.** _ ☐ **f.** _ ☐ **f.** _ ☐ **f.** _ ☐
10.	Për personat juridik: **VËRTETIM nga Administrata Tatimore e Kosovës** që dëshmon se aplikuesi e ka të shlyer tatimin në fitim (në origjinal) Për personat fizik: **VËRTETIM nga komuna** që ka të shlyer tatimin në pronë*	**f.** _ ☐	
11.	**AUTORIZIMI PER APLIKIM -** Në rast se aplikuesi është person fizik, aplikimi mund të bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri - në origjinal. Në rast se aplikuesi është ndërrmarje, i autorizuari për aplikim duhet të jetë punëtorë i ndërmarrjes. **AUTORIZIMI PËR MENAXHIM TË PROJEKTIT-** Në rast se aplikuesi është person fizik, autorizimi per menaxhim bëhet përmes një personi të autorizuar, ai pranohet vetëm përmes autorizimit të vërtetuar nga noteri - në origjinal. Në rast se aplikuesi është ndërrmarje, i autorizuari për menaxhim duhet të jetë punëtorë i ndërmarrjes me kontrate pune jo me te shkurter se 5 vjet.	**f.** _ ☐	
12.	**CERTIFIKATA E PRONESISE (FLETA POSEDUESE) QË DËSHMON PRONËSINË MBI TOKËN DHE KOPJA E PLANIT** ose **KONTRATA E QIRAMARRJES SË TOKËS** për së paku 10 vjet (e noterizuar) me kopjen e fletës poseduese të pronarit dhe kopjen e planit të bashkangjitur, përveç në rast të majmërisë së viçave kur dëshmohet toka si bazë ushqimore, toka e marrë më qira, duhet të jetë për së paku 3 vjet dhe nëse ka investime në makineri bujqësore, kontrata e tokës duhet të jetë për 5 vjet.	**f.** _ ☐	
13.	Në rast të kontratave për qiramarrje nga APK-ja, të cilat janë për kohë më të shkurtër se sa është paraparë në masë, aplikuesi duhet të sjell një vërtetim nga qiradhënësi me të cilin vërteton se nuk do të ketë problem për vazhdimin e kontratës së qirasë.		**f.** _ ☐
14.	**LISTA E KONTRATAVE** me përpunuesit ose blerësit dhe kopjet e kontratave – nëse aplikuesi i posedon ato (nuk janë të obligueshme, por janë kriter i përzgjedhjes)		**f.** _ ☐
15.	**Dëshmi që vërteton se aplikuesi ka përfunduar se paku SHKOLLËN FILLORE-kopje e noterizuar**.**	**f.** _ ☐	
16.	**DEKLARATË**- se në rast të marrjes së grantit, para kërkesës për pagesë, do të kontraktoj këshilltar ose kompani të licencuar për shërbime këshillimore nga MBPZHR me kontratë të noterizuar		**f.** _ ☐
Dokumente tjera specifike sipas nënmasës			

101. 1 Pemët		Nuk kërkohen dokumente shtesë		
101. 2 Perimet		Nuk kërkohen dokumente shtesë		
17.	101.3 Mishi	**CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN PËR IDENTIFIKIMIN E KAFSHËVE me numër të viçave apo derrave**		**f. _ ☐**
18.	101.4 Qumështi	**CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN PËR IDENTIFIKIMIN E KAFSHËVE** me numër të lopëve qumështore / deleve / dhive		**f. _ ☐**
19.	101.5 Rrushi	**Nuk kërkohen dokumente shtesë**	**f. ☐**	
20.	101.6 Vezët	**FATURA E BLERJES SË FUNDIT TË PULAVE** (si dëshmi se aplikuesi ka pula në prodhimtari aktive)	**f. _ ☐**	

*Nese aplikuesi nuk ka prone te tatueshme ne emrin e tij, ai duhet te sjelle nje vertetim nga komuna qe verteton kete fakt.

**Dëshmi për përfundimin e së paku shkollës fillore është edhe dëshmia e përfundimit të shkollës së mesme apo të shkollimit të lartë.

Shtojca nr. 3 Model për përgatitjen e projekt-propozimit

MODEL PËR PËRGATITJEN E PROJEKT-PROPOZIMIT

SHËNIM! ***Ky dokument duhet të respektohet në tërësi.*** **Ky dokument nuk është për t'u plotësuar por është një model si të shkruhet një projekt-propozim. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës.**

1 Informata të përgjithshme

1.1 Emri i përfituesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

1.2 Asetet kryesore në pronësi të përfituesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë),objekte, pajisje dhe makineri, kafshë, etj. – sikur në Regjistrin e fermës

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimi	Vlera e blerjes për persona fizikë ose gjendja e fundit e bilancit për persona juridik	Sasia (me copë)
1. Objektet – gjithsej			
1. 1 detaje……..			

1. n detaje……			
2. Pajisje – gjithsej			
2. 1 detaje……..			
2. n detaje……			
3. KAFSHË			
3. 1 detaje……..			
3. n detaje……			
4. Të tjera - detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik (toka në emër të aplikuesit apo e marrë me qira)
1			
n			

2 Përshkrimi i projektit

2.1. Emërtimi i investimit

2.2. Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati)

2.3. Qëllimi, me përshkrimin e objektivave, arsyetimit të nevojës dhe mundësisë së investimit

3 Të dhëna lidhur me fuqinë punëtore dhe menaxhimin e projektit

3.1 Menaxheri teknik juridik (emri, mbiemri, pozita brenda organizatës, studimet relevante dhe përvoja profesionale).....

3.2 Numri i përgjithshëm i punonjësve aktual……..

prej të cilëve.....punëtorë

3.3 Vlerësimet rreth fuqisë punëtore që do të angazhohet pas zbatimit tëprojektit ……..

Numri i vendeve të reja të punës të krijuara si rezultat i investimit:.....

4 Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Emri, numri, vlera, karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë/pajisjeve/ teknologjive/mjeteve të transportit/pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe, nëse është e nevojshme, prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet. Prokurimet duhet të bazohen në kapacitetet aktuale dhe /ose të parashikuara të prodhimit.

Tabela 5. Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë	Njësitë (copë, m², kg, etj.)	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindja e përkrahjes publike
GJITHSEJ						

Shënim! Nuk është e lejuar që të ceken emrat e prodhuesve, markat tregtare, emrat e ofertuesve, etj.

5 Kalendari i zbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera, muaj dhe aktivitete.

Tabela 6. Shembull/Orari për shpërndarje

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti 2018		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
p.sh. Themelet e stallës	5000		
p.sh. muret e stallës		5000	
p.sh. kulmi i stallës			5000

Tabela 7. Shembull/Orari për ndërtimin e objekteve të reja

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti 2018		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
psh. përbërësit e ndërtimit	5000		
psh. ndërtimi i katit të Parë		5000	
psh. dritaret dhe kulmi			5000

6 Kapaciteti prodhues

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi fizike). Duhet të paraqiten specifikimet e kapacitetit para dhe pas finalizimit të investimit. **Duhet të jepet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në teknologjinë e projektit.**

7 Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 8. Furnizuesit potencial të aplikuesit

Furnizuesit potencial të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndët e para/materialet ndihmëse/produktet/ shërbimet	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafërt	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
n				

Tabela 8. Klientët potencial të aplikuesit

Klientët potencial të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa)	Vlera	% e shitjes
1			
2			
n			

Tabela 9. Detaje financiare të investimit

Shpenzime të detajuara të pranueshme dhe të papranueshme

Shpenzimet e pranueshme	**Përkrahja publike**	**Bashkëfinancimi privat (euro)**	**Totali**
Investimet e pranueshme			

...			
Shpenzimet administrative (për shembull: planin e biznesit)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

Shtojca nr. 4 Model për përgatitjen e planit të biznesit

Ministria e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MODEL PËR PËRGADITJEN E PLANIT TË BIZNESIT

për projektet e përkrahura nga Ministria e Bujqësisë,

Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

SHËNIM!

Ky dokument duhet të respektohet në tërësi. **Ky dokument nuk është për tu plotësuar por është një model si të shkruhet plani i biznesit. Në rast se ekziston ndonjë kapitull që nuk ndërlidhet me projektin tuaj, ju duhet që një gjë të tillë ta cekni brenda kapitullit përkatës.**

1 Informata të përgjithshme

1.1 Emri i përfituesit (me të dhënat e tij specifike të identifikimit)

Për personat fizik:

Emri dhe Mbiemri
Adresa e plotë
NIF:
Numri i telefonit

Për personat juridik:

Emri i ndërmarrjes
Adresa e ndërmarrjes
Numri fiskal
Pronarët e ndërmarrjes
Personi i autorizuar per menaxhim te projektit
Numri kontaktues i telefonit

1.2 Asetet kryesore në pronësi të aplikuesit: tokë (me specifikim të llojit të pronësisë), objekte, pajisje dhe makineri, kafshë, etj. – sikur në Regjistrin e fermës.

Tabela 1. Asetet e aplikuesit

Asetet	Data e blerjes / ndërtimit	Vlera e blerjes per persona fizik ose gjendja e fundit e bilancit per persona juridik	Sasia (me copë)
1. Objektet – gjithsej			
1.1 detaje……..			
1. n detaje……			
2.Pajisje – gjithsej			
2.1 detaje……..			
2. n detaje……			
3. KAFSHË			
3.1 detaje……..			
3. n detaje……			
4. Të tjera - detaje			
GJITHSEJ			

Tabela 2. Toka

Nr.	Rajoni/Komuna/Fshati	Sipërfaqja (m²) / lloji i shfrytëzimit	Statusi juridik (pronë e aplikuesit, pronë

			familjare apo e marrë me qira)
1			
n			

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

2 Të dhëna për personat e ekonomisë familjare/ndërmarrjes

2.1 Për persona fizik:

Tabela nr. 3. Të dhëna për anëtarët e ekonomisë familjare

Nr.	Emri dhe mbiemri	Viti i lindjes	Gjinia (M/F)	Profesioni/ vendi i punës	Të ardhurat (€)
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

Tabela nr. 4. Pasqyra e prodhimeve kryesore të dy viteve paraprake

Nr	Produkti/ shërbimi	Njësia	Viti					
			2016			2017		
			Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera
1								
2								
3								
4								
5								
Gjithsej								

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

1.2 Për persona juridik

Tabela nr. 5. Të dhëna për ndërmarrjen

Nr.	Pronarët (emri & mbiemri)	% e akcioneve	Aktivitetet e ndërmarrjes	Qarkullimi në vitin 2016	Qarkullimi në vitin 2015
1					

2					
3					

Tabela nr. 6. Pasqyra e prodhimeve kryesore të dy viteve paraprake

Nr	**Produkti/ shërbimi**	**Njësia**	**Viti**					
			2016			**2017**		
1			**Sasia**	**Çmimi**	**Vlera**	**Sasia**	**Çmimi**	**Vlera**
2								
3								
4								
5								
6								
Gjithsej								

Shto rreshta tjerë nëse ka nevojë!

2 Përshkrimi projektit

2.1 Emërtimi i investimit

2.2 Vendi i projektit (rajoni, komuna dhe fshati)

2.3 Objektivat,

2.4 Arsyetimi i nevojës dhe mundësia e investimit

2.4 Duhet të ceket përputhshmëria mes objektivave të masës dhe objektivave të projektit. Sqarime për objektivat e përgjithshme dhe së paku për njërën prej objektivave te projektit duhet të bëhet paraqitja sipas tabelës në vijim:

Tabela 7. Harmonizimi i objektivave te programit me ato te projektit

Objektivat e pergjithshme dhe specifike	Objektivat e projektit (Shkruaj „x" në katrorin pranë objektivit të arritur)	Përshkrimi se si projekti synon që të arrijë objektivat (shkruaj brenda katrorëve të kësaj kolone paralel me objektivin e nën/masës
Aftësia konkuruese	☐	

Se pakunjeprejobjektivavespecifike ne vijim:		
Objektiva specifike të masës dhe nënmasës Hartuesi i projektit i merr objektivat e masës dhe nënmasës nga Programi dhe i paraqet në këtë kolonë	☐ ☐ ☐	

Tabela 8. Informata teknike dhe financiare

	Objektivat e projektit Shkruaj „x" në katrorin pranë objektivit të arritur)	**Pershkrimi se si projekti synon që të arrije objektivat** (shkruaj brenda katrorëve të kësaj kolone paralel me objektivin e nën/masës
Projekti është në linjë me potencialin e zonës (obligative)	☐	
Objektivat teknike (së paku një prej të poshtë shënuarave janë të obligueshme)**:** Shpërndarja e mjeteve dhe pajisjeve që mund të ndikojnë në rritjen e prodhimit të punës, përmiresimin e kualitetit të produkteve bujqesore, futja në përdorim e teknologjive të reja dhe permiresimi i kushteve të punës; Ndërtimi dhe modernizimi i objekteve prodhuese të cilat sigurojnë standarde më të mira; **Indikatori financiar** (obligativ): Kthimi i investimeve është koha e nevojshme që fitimi neto shtesë të mbuloj shpenzimet e investimit (**shitja shtesë - shpenzimet shtesë të lidhura me investimin)	☐ ☐	

***Duhet të bëhet nje paraqitje ku theksohet saktësisht se për sa kohë duhet të përfundoj kthimi i investimit. Duhet të merren parasysh vetëm investimet që në mënyre direkte gjenerojnë të hyra shtesë (si p.sh. traktor, apo ndonjë mjet për mjelje por jo shtallë apo depo e plehut etj.); **Ne rast të pemishteve të reja, vreshtave të rrushit ose pemëve të buta vlera shtesë e shitjes duhet të llogaritet për ate vit kurbimët fillojnëtë japin rendimente maksimale; *** paraqitja duhet të mbeshtetet në të ardhurat dhe shpenzimet dhe të paraqiten në tabelën 11.	☐ ☐	

3 Të dhëna lidhur me fuqinë punëtore dhe menaxhimin e projektit

3.1 Menaxheri (emri, mbiemri, pozita brenda organizatës, studimet relevante dhe përvoja profesionale) .....

3.2 Numri i përgjithshëm i punonjësve aktualë ……..

prej të cilëve ..... punëtorë

3.3 Vlerësimet rreth fuqisë punëtore që do të angazhohet pas zbatimit të projektit ……..

Numri i vendeve të reja të punës të krijuara si rezultat i investimit: .....

4 Përshkrimi i blerjeve të kryera përmes projektit

Emri, numri, vlera, karakteristikat teknike dhe funksionale të makinerisë / pajisjeve / teknologjive / mjeteve të transportit / pajisjeve që do të blihen përmes projektit dhe, nëse është e nevojshme, prezantimi teknik i objekteve ku do të vendosen pajisjet dhe mjetet. Blerjet duhet të bazohen në kapacitetet aktuale dhe /ose të parashikuara të prodhimit.

Tabela 9. Përshkrimi i blerjeve/investimeve të kryera përmes projektit

Nr.	Emri / lloji i pajisjeve / makinerisë /shërbimeve etj.	Njësitë (m², ditë pune, kg, etj.)	Vlera pa TVSh	TVSh	Gjithsej vlera me TVSh	Përqindia e përkrahjes publike

GJITHSEJ						

Shënim! Nuk është e lejuar që të ceken emrat e prodhuesve, markat tregtare, emrat e ofertuesve, etj.

5 Kalendari zbatimit (muajt) dhe fazat kryesore

Orari i investimit i shprehur me vlera, muaj dhe aktivitete.

Tabela 10. Planifikimi kohor i realizimit të investimeve

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (p.sh.: 2018)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
p.sh. përgatitja e tokës	5,000		
p.sh. mbjellja e fidaneve		15,000	
p.sh. sistemi mbajtës			8,000

Tabela 11. Planifikimi kohor për ndërtimin e objekteve të reja

Lloji i investimit dhe kostoja totale (euro)	Viti (p.sh.: 2018)		
	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
p.sh. përbëresit e ndërtimit	5,000		
p.sh. Ndërtimi i katit të 1-re		10,000	
p.sh.kati i 1-re dritaret dhe kulmi			5,000

6 Kapaciteti prodhues

Kapacitetet prodhuese që rezultojnë nga investimi (në njësi matëse). Duhet të paraqiten specifikimet lidhur me kapacitetin para dhe pas finalizimit të investimit.

Duhet të jepet përshkrimi i rrjedhës teknologjike të punës që aplikohet në tekonlogjinë e projektit.

7 Furnizimi i tregut / shitja

Tabela 12 Furnizuesit potencial të aplikuesit

Furnizuesit potencial të aplikuesit				
Emri i furnizuesit me lëndet e para/produktet / shërbimet (kur furnitori është vendor të vendoset shenja „V" pas emrit)	Adresa	Produkti furnizues dhe shuma e përafert	Vlera e llogaritur	% nga shpërndarja totale
1				
2				
n				

Tabela 13. Klientet potencial të aplikuesit

Klientet potencial të aplikuesit			
Nr.	Klienti (Emri dhe adresa) kur blerësi është vendor të vendoset shenja „V" pas emrit	Vlera	% e shitjes
1			
2			
n			

8 **Konkurrenca dhe strategjia e tregut**

Përshkrimi i konkurrencës lokale dhe ndërkombëtare. Përshkrimi i strategjisë së tregut.

9 Detaje financiare të investimit

Tabela 14.Shpenzime te detajuara të pranueshme dhe të pa pranueshme

Shpenzimet e pranueshme	**Ndihma publike**	**Bashkë-fiancimi privat (euro)**	**Totali**
Investimet e pranueshme			

...			
Shpenzimet administrative (për shembull: planin e biznesit)			
Investimet e papranueshme			
TOTALI			

10 Rrjedhja e parasë (hyrje-daljet)

Parashikimi i hyrjeve dhe daljeve për 3 vjet pas finalizimit te investimit. Aplikuesi duhet të demonstrojë se ekonomia e tij do të jetë fitimprurëse dhe se paratë e gatshme asnjë muaj nuk do të ketë vlerë negative. Nëse aplikuesi planifikon të marrë kredi, atëherë shuma e parave e marrë nga kredia regjistrohet si e hyrë kurse këstet mujore për kthimin e kredisë regjistrohen si shpenzim.

Personat juridik me përvojë duhet të dorëzojnë pasqyrat e të ardhurave për tre vitet e fundit që i kanë dorëzuar në Administratën Tatimore.

Tabela 15. Rrjedhja e parasë (Ju lutemi, shfrytëzojeni tabelën në excel publikuar në webfaqe e AZHB)

	Te hyrat		Shpenzimet		Para te gatshme ne dispozicion (euro)
	Artikulli	Vlera (euro)	Artikulli	Vlera (euro)	
Te hollat fillestare 2018, Muajt					
Janar					Te hollat fillestare + Te ardhurat - Shpenzimet = Duhet te jene pozitive
Shkurt					.....
.....					.....

Shtojca nr. 5 Kontrata për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural

Masa/Nënmasa.....

Kontrata për financimin e projekteve investuese
të zhvillimit rural
Nr.....

Në mes të:

Agjencitë për Zhvillim e Bujqësisë (AZHB), adresa.....,nr i telefonit.....përfaqësuar nga....., Shefi i Agjencisë për Zhvillim e Bujqësisë (AZHB),në njërën anë,
dhe
Zotit. /Zonjës.....,
Numri personal.....,
Numri unik i identifikimit nëregjistrin e fermerëve.....,

si person fizik osesi përfaqësues i personit juridik.....,

Numri fiskal.....,

Adresa.....,

Nr. i telefonit.....,

si përfitues, në anën tjetër,

Në këtë dokument të ashtuquajturat "Palët",

pajtohen të nënshkruajnë kontratën sipas formularit për aplikim <numrit të regjistrimit>, shtojcave dhe në <titullin> e projektit të paraqiturnga përfituesi dhe shtojcat e saj sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1: Dispozita të përgjithshme

1.1 Ky dokument duhet të krijojë kornizë juridike dhe operative për AZHB për financimin e projektit tëpërfituesit **<numrin e regjistrimit>**
1.2 Përfituesi do të financohet sipas kushteve të parapara në kontratë, për të cilat përfituesi deklaron se i njeh dhe i pranon.
1.3 Pjesë detyruese të kontratës janë:
   a) Formulari i aplikimit dhe shtojcat e saj
   b) Projekti (plani i biznesit ose projekt-propozimi) dhe shtojcat e projektit të paraqitura nga përfituesi, pas vlerësimit (pranueshmëria dhe kriteret përzgjedhëse për të cilat janë dhënë pikët),së bashku me të gjitha modifikimet që janë bërë gjatë vlerësimit.
   Përfituesi është i obliguar t'i respektojë tërësisht këto kushte gjatë implementimit (derisa të bëhet pagesa e fundit) dhe 5 vjet pasi që të bëhet pagesa e fundit, gjatë periudhës së monitorimit.

1.4 Përfituesi pranon ndihmën publike dhe do të angazhohet për zbatimin e projektit në përgjegjësinë e vet duke respektuar dispozitat e kësaj kontrate dhe legjislacionin kombëtar

Neni 2: Implementimi dhe vlefshmëria e kontratës

2.1 Implementimi i kontratës fillon prej momentit që kontrata është nënshkruar nga të dyja palët. Koha e implementimit të investimit është.....muaj, siç është paraparë në masë dhe paraqet afatin për kërkesën e fundit të pagesës.
2.2 Vlefshmëria e kontratës përfshin periudhën kohore prej momentit të nënshkrimit të kontratës deri tek ekzekutimi i pagesës së fundit dhe 5 vjet të periudhës monitoruese e cila llogaritet nga data e ekzekutimit të pagesës së fundit.

Neni 3: Vlera e Kontratës

3.1 Vlera totale e përkrahjes publike të projektit të financuar është <në nr> dhe (<në shkronja>).
3.2 Vlera totale e pranueshme e projektit është <në nr> dhe (<në shkronja>).
3.3 Vlera totale e projektit (përkrahja publike + bashkëfinancimi privat + shpenzimet e papranueshme) është <në nr> dhe (<në shkronja>).

Neni 4: Pagesa

4.1 Pagesa mund të bëhet në dy këste në rast të projekteve me vlerë 20,000 Euro ose më shumë të shpenzimeve të pranueshme dhe në një pagesë në rast të projekteve më të vogla se 20,000 euro.

4.2 Në rastin kur Përfituesi ka të drejtë të paraqesë 2 kërkesa për pagesë, kërkesa e parë duhet të jetë më e madhe se 50% e totalit të ndihmës publike. Shpenzimet e pranueshme administrative (që kanë lidhje me përgatitjen teknike të projektit, planin e biznesit, inxhinierët, arkitektët, etj.) mund të kërkohen si rimbursim në përputhje me përqindjen e këstit.

4.3 Pagesa duhet të ekzekutohet duke u bazuar në kërkesën e pagesës së paraqitur nga përfituesi tek AZHB-ja. Autorizimet e pagesës do të bëhen në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga përfituesi dhe rezultateve të kontrollit sipas udhëzimeve administrative të AZHB-së. Çdo autorizim i pagesës mund të bëhet i pavlefshëm në rast të ndonjë pa rregullsie të vërejtur, gjatë vlefshmërisë së kontratës.

Neni 5: Kontrollimi dhe monitorimi i projektit gjatë vlefshmërisë së kontratës

5.1. Përfituesi është i obliguar t'i ofrojë qasje të plotë çdo kontrolle të bërë nga AZHB që ndërlidhet me investimin e bërë, duke përfshirë edhe të dhënat mbi punëtorët, kontabilitetin dhe taksat e paguara.

5.2. Në qoftë se AZHB vëren se investimi publik i financuar nuk është përdorur sipas qëllimit të tyre, planit teknik të projektit dhe planit të biznesit, ose është shitur ose dhënë me qira, AZHB ka të drejtë dhe obligim ligjor që të kërkojë kthimin e shpenzimeve të bëra.

5.3. Përfituesi është përgjegjës që ta ruajë qëndrueshmërinë ekonomike të investimit dhe të demonstrojë dobishmërinë e tij publike.

Neni 6: Plotësime të kontratës

6.1. Përfituesi mund të kërkojë që të bëhen modifikime në kontratë vetëm në qoftë se ato nuk ndryshojnë pranueshmërinë dhe rezultatin e projektit dhe vetëm gjatë periudhës implementuese. Sidoqoftë, këto modifikime nuk mund të kenë efekt retroaktiv. Modifikimet mund të ndikojnë në aspektin financiar dhe teknik vetëm nëse janë në përputhshmëri me masën, nëse nuk ndryshojnë qëllimin kryesor të projektit dhe nëse janë të limituara në maksimum 10% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

6.2. Mbështetja totale publike që është aprovuar fillimisht nuk mund të rritet në asnjë rrethanë.

6.3. AZHB mund të miratojë ndryshime/plotësime tëkontratës sipas kërkesës së përfituesit, duke u bërë ato pjesë të kontratës.

6.4. Të drejtat dhe obligimet e kontratës nuk mund të jepen nga përfituesi palës së tretë pa ndonjë marrëveshje specifike nga AZHB. Në këso raste AZHB ka për detyrë që ta mbikëqyrë në vazhdimësi mirëmbajtjen e kritereve të pranueshmërisë dhe atyre të përzgjedhjes.

Neni 7: Ndërprerja e kontratës

7.1.Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të argumentuara mirë, duke përfshirë "force majeure", pasi të diskutohet mes palëve, AZHB mund të vendosë që të ndërpresë kontratën pa miratimin e përfituesit, dhe ta kthejë mbështetjen e marrë publike.

7.2. Palët mund të vendosin në ndërprerjen e kontratës sipas një marrëveshjeje të përbashkët, në këtë rast përfituesi duhet ta kthejë gjithë mbështetjen e marrë publike.

7.3. Në rast të vërejtjes së ndonjë parregullsie në ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë rastet kur përfituesi nuk është në gjendje që ta bëjë pagesën apo ka falimentuar, ose nëse është vërejtur se dokumentet e ofruara janë të rreme/skaduara/jo të plota/nuk pasqyrojnë realitetin, atëherë AZHB duhet ta ndërpresë kontratën duke e njoftuar me shkrim përfituesin, pa asnjë vonesë dhe pa asnjë formalitet tjetër dhe pa ndërhyrje të ndonjë ligji apo gjykate. Në rast të tillë përfituesi duhet ta kthejë tërë mbështetjen e marrë.

7.4. Në çdo kohë, në rast të ndonjë dyshimi AZHB mund ta pezullojë përkohësisht kontratën dhe pagesat, si masë paraprake deri në përfundim të hetimeve, pa ndonjë njoftim.

Neni 8: Forcë majeure (forca madhore)

8.1.Në rast të situatës që vlerësohet si "force majeure", pala është e përjashtuar nga përgjegjësitë që parashihen me këtë kontratë.
8.2. Force majeure është përcaktuar si një ngjarje e cila është e paparashikueshme dhe e pamundur për t'u shmangur nga palët dhe që pengon kontratën për t'u ekzekutuar.
8.3. Si forcë majeure mund të konsiderohen rastet siç janë: tërmetet, vërshimet, lufta, revolucionet, embargot, etj.
8.4. Çdo rast që konsiderohet"force majeure" duhet të dëshmohet dhe pranohet nga AZHB.

Neni 9: Komunikimi në mes të palëve

9.1. Çdo këmbim i informatës në lidhje me këtë kontratë duhet të jetë në formë të shkruar: direkt, me e-mail ose faks.
9.2. Njoftimet verbale nuk do të merren parasysh nëse nuk janë përcjellë edhe me njoftime në formë të shkruar siç është cekur në nenin 9.1.

Nënshkruar nga përfaqësuesi i AZHB-së ose përfaqësuesi i tij ligjor	**Nënshkruar nga Përfituesi**
Emri dhe Mbiemri	**Emri dhe Mbiemri**
.....	**.....**
Nënshkrimi	**Nënshkrimi**
.....	**.....**
Data:	**Data:**

PROCEDURAT E PROKURIMIT

(t'i bashkëngjiten kontratës sëAgjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për përfituesit)

1. Dispozitat e përgjithshme të zbatueshme për të gjitha llojet e blerjeve

- Asnjë nënkontraktues i kontraktuar nga përfituesi nuk mund tëkontraktojë ndonjë nënkontraktues tjetërpër realizimin e kontratës;
- Blerjet duhet t'i respektojnë investimet që përmbushin kriteret epërshtatshmërisë të përcaktuara në kuadër të masave dhe udhëzimeve të planit të biznesit psh. për sa i përketkthimit të investimeve, rrjedhës së parasë,etj.;
- Procedurat e prokurimit vlejnë vetëm për investimet e pranueshme. Për investimete papranueshme nuk janë të obligueshme procedurat e prokurimit;
- Ka 3 lloje të procedurave: blerjet e drejtpërdrejta, blerjet me së paku 3 oferta dhe përzgjedhje të bazuar në prokurim me shpallje publike (tender i hapur);
- Procedura për blerjet që do të aplikohen është në varësi të vlerës së blerjeve; Është e ndaluar ndarja e blerjeve për llojin e njëjtë të mallrave, punimeve apo shërbimeve me qëllim të shmangies së rregullave procedurale të aplikueshme për një prag më të lartë;
- Ofertuesit nuk duhet të jetë në konflikt të interesit;
- Ofertuesit do të përjashtohen nga dhënia e kontratave;në rastin e shtrembërimit të informacionit të kërkuar nga përfituesi ose nëse dështojnë për të dhënë këtë informacion. Respektimi i rregullave të prokurimit është kusht i detyrueshëm për t'u pranuar shpenzimet. Prandaj, dosja e kërkesës duhet të përmbajë dokumentet e pagesave për të dëshmuar plotësimin e procedurave të prokurimit, shih shtojcën 5.

2. Kriteret e dhënies së kontratës

Kontratat duhet të jepen duke u bazuar në këto kritere:

A. **Në rast të furnizimit me mallra**- të bazuar në çmimin më të ulët;

B. **Në rastin e ndërtimit**(nënkupton rezultatin e ndërtimit ose projektit të inxhinierisë civile që vetvetiu është e mjaftueshme të plotësojë një funksion ekonomik ose teknik dhe mbulon të dyja dizajnimin dhe ekzekutimin) - bazuar në çmimin më të ulët;

C. **Në rast të shërbimeve**(studime ose për ndihmë teknike) - bazuar në çmimin më të ulët;

Përkufizimi i konfliktit të interesit

- Ekzistimi i lidhjeve ndërmjet përfituesit dhe furnizuesit (të afërm, apo aksionarë të përbashkët në kompanitë ofertuese) ose në mes te anëtarëve të Komitetit Vlerësues.
- Pronësia e përbashkët (si individë ose si aksionarë) në mesin e furnizuesve të cilët dorëzojnë oferta.

3. Procedurat e blerjes:

3.1 Blerjet direkte deri në 10,000.00 euro.

Rregullat:

- Përfituesi mund të blejë drejtpërdrejt nga tregu,
- Kostoja e blerjes duhet t'i respektojë pragjet e vendosura në masë,

- Nuk ka nevojë për një kontratë të nënshkruar në mes të shfrytëzuesit dhe furnizuesit, përveç në rast të shpenzimeve të konsulencës.
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.2 Përzgjedhja bazuar në të paktën 3 oferta për blerjet në vlerë prej 10,000.01 euro deri në 60,000.00 euro.

Rregullat:

- Blerjet mund të bëhet vetëm me së paku 3 oferta (kuotim i çmimit),
- Shpenzimet brenda ofertës duhet t'i respektojnë edhe pragjet e vendosura brenda masave;
- Në të gjitha rastet, duhet të nënshkruhet kontrata mes përfituesit dhe furnizuesit,
- Ftesat për oferta, ofertat dhe kontrata duhet të respektojnë dispozitat/detajet e të cilave janë paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe brenda planit të biznesit;
- Përfituesi duhet të dërgojë një ftesë për oferta, duke respektuar një format standard-shih shtojcën nr. 1 të kontratës;
- Furnizuesit duhet të regjistrojnëofertën e tyre në regjistrin e hyrje/daljeve.
- Përfituesi duhet të nënshkruajëdeklaratën për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit-shih shtojcën nr. 2 të kontratës.
- Ofertuesit duhet të nënshkruajnë deklaratën e tenderuesit tëbesueshëm-shih shtojcën 3.
- Përfituesi vendos për dhënien e kontratës ofertuesit dhe argumenton arsyen e përzgjedhjes;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

3.3 Prokurimi me shpallje publike (tender i hapur) –për blerjet në vlerë mbi 60,000.00 euro

Rregullat:

- Të gjitha dispozitat nga pika 3.2. duhet të respektohen;
- Përfituesi duhet tapublikojë interesin e tij për blerjen përmes shpalljes në së paku 1 gazetë të përditshme kombëtare, por në qoftë se vlera është më e lartë se 150,000 €, tenderi duhet të paraqitet edhe në mediet ndërkombëtare. Përveç kësaj, përfituesi ka të drejtë të dërgoj direkt ftesat për furnizuesit e mundshëm për të siguruar një konkurrencë më të mirë në mesin e ofertave, por vetëm në të njëjtën ditë kur është shpallur tenderi;
- Përmbajtja e ftesës publike duhet të përfshijë të gjithë informacionin e paraqitur në Shtojcën1;
- Afati kohor për marrjen e ofertave duhet të jetë të paktën 10 ditë; Përfituesi do të krijojë një komision vlerësimi. Ky komision duhet të ketë një numërtek të anëtarëve, të paktën tre, me të gjitha kapacitetet teknike dhe administrative të nevojshme për të dhënë një opinion të vlefshëm mbi tenderët;
- Komisioni i vlerësimit duhet të lëshojë një vendim të argumentuar për dhënien e tenderit.
  Anëtarët e komisionit të vlerësimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë të konfidencialitetit dhe neutralitetit. Shih Shtojcën 4;
- Të gjitha kërkesat për pjesëmarrje dhe tenderët që i plotësojnë kërkesat, duhet të vlerësohen dhe renditen nga komisioni i vlerësimit në bazë të kritereve të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës të shpallura paraprakisht;
- Përfituesi duhet të kërkojë dhe të pranojë kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe kopjen e certifikatës së numrit fiskal të ofertuesve.

Shtojca 1. e Kontratës Ftesë për dorëzimin e një ofertë

Emri i përfituesit privat.....
Numri i regjistrimit të Biznesit ose numri personal i identifikimit.....
Numrit fiskal.....
Adresa.....
Fiks. tel. /faks/e-mail.....Nr.....Data.....

Për: Emri i kompanisë ……E pranuar sot:**.....**
Nr.....Data.....
Emri dhe Mbiemri:.....

Nr. i regjistrimit të biznesit.....
Numri fiskal.....
Nënshkrimi.....

Ftesë për dorëzimin e një oferte
(Formular)

Të nderuar Zonja/Zotëri,

(Emri i Përfituesit) ju fton që ta paraqitni ofertën tuaj për (lloji i blerjes).....për zbatimin e një projekti të bashkë-financuar nga MBPZHR nënmasën/nënmasën kodin<masa/nën-masa dhe emri>me titullin e mëposhtëm titulli i projektit, i cili do të zbatohet në komunën<Emri komuna>.

Përzgjedhja përdhënien e kriterit është..... (*duhetpërmendursipas llojittëkontratës, siç paraqitetnëpikën2 tëkëtij dokumenti-Kriteretpër dhënien e çmimit*);

Kontrata do të konsistojë në blerjen/përvetësimin e.....
.....për implementimin e projektit tëlartpërmendur;

Lloji i kontratës: blerja e <shërbimeve/mallrave/punë ndërtuese>;
Afati i fundit për dorëzimin e ofertës: <data>, <ora>.
Adresa ku do të dorëzohen ofertat.....
Data dhe ora kur do të fillojë vlerësimi.....
Vlera maksimale e blerjes.....
Bashkangjitur i gjeni sasitë, specifikimet teknike/termat e referencës për ofertën e kërkuar (të jetë e bashkangjitur siç është paraqitur në kuadër të projektit teknik dhe, nëse është e zbatueshme, në kuadër të planit të biznesit).
Ne presim ofertën tuaj deri në afatin e përcaktuar dhe në adresën e përmendur më lart.

<Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit>

NënshkrimiVendi dhe data

Shtojca 2 e Kontratës

Deklaratë

për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit

Unë, i nënshkruari.....,si përfaqësues ligjor i projektit, deklaroj nën sanksionin e Ligjeve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, se i respektoj të gjitha rregullat e përcaktuara si më poshtë:

1. Nuk ekzistojnë lidhje (të afërmit, apo aksionarë të përbashkët për çdo kompani) ndërmjet përfituesit (apo partnerë të përfituesve) dhe tenderuesve (ose partnerët e tenderuesit),të cilët dorëzojnë oferta;

2. Nuk ka pronësi të përbashkët (si individë ose si një aksionar) në mesin e ofertuesve nga i cili kam marrë oferta.

<Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor tëpërfituesit>

Nënshkrimi

Data

Shtojca 3 e kontratës

Deklarata për seriozitetin e ofertuesit

Unë, i nënshkruari, si përfaqësues ligjor i projektit, vërtetoj nën sanksionin e ligjeve të agjencisë së pagesave se nuk jam në njërën prej situatave të listuara më poshtë:

Në falimentim ose duke u likuiduar, në afera **të administruara nga gjykatat**, **kam hyrë në një marrëveshje me kreditorët**, aktivitetet të suspenduara të**biznesit, u nënshtrohem procedurave ligjore lidhur me ato çështje**, ose në ndonjë **situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale**;

Kam qenë i dënuar për ndonjë shkelje lidhur me sjelljen profesionale përmes një gjykimi të plotfuqishëm (res judicata); kam qenë fajtor për shkelje të rëndë profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund të justifikojëpërfituesi;

Nuk kam përmbushur detyrimet lidhur me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose për pagesën e tatimeve, në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin unë jam përcaktuar dhe në vendin e përfituesit;

Kam qenë objekt i një gjykimi të plotfuqishëm (res judicata) për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Kosovës;

Aktualisht i nënshtrohem një ndëshkimi administrativ financiar të lëshuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e cila është përgjegjëse për subvencione dhe grante për bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë.

Jam deklaruar si i papranueshëm për Bankën Botërore, Danidën ose Komisionin Evropian.

<Emri dhe Mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit>

Vendi dhe data Nënshkrimi

Shtojca 4 e Kontratës

Deklaratë

e konfidencialitetit dhe neutralitetit

Unë, i nënshkruari, anëtar i komisionit të vlerësimit për blerjen e.....,nën procedurën e aplikuar <përzgjedhja bazohet në të paktën 3 oferta ose përzgjedhje në bazë të prokurimit të reklamuarorganizuar nga<emri iPërfituesit>,
Unë deklaroj nën sanksionin e Ligjeve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, më poshtë:
a) Unë nuk kam asnjë të afërm apo aksione ose partnerë të biznesit në mes të ofertuesve dhe komisionit vlerësues;
b) Unë nuk jam anëtar i ndonjë Bordi, trupi vendimmarrës ose mbikëqyrës për ndonjë nga tenderuesit;
c) Unë nuk kam asnjë interes që mund të ndikojnë në neutralitetin tim gjatë vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu, unë do të angazhohem plotësisht në ruajtjen e konfidencialitetin të përmbajtjes së ofertave edhe të veprimtarisë së komisionit të vlerësimit në rast se informacioni mund të ndikojë në të drejtat ligjore pronë e tenderuesit, ose sekretet e tyre tregtare.

<Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor të përfituesit>

Vendi dhe data Nënshkrimi

Shtojca 5 e kontratës

Dokumentet që duhet të dorëzohen bashkë me kërkesën për pagesë, varësisht nga procedura e prokurimit

	*Vlera e tenderit		
Numri i dokumentit	Deri në 10, 000 euro ☐	10, 000,01 – 60, 000 euro ☐	Më shumë se 60, 000,01 eur☐
Lloji i blerjes	a. Mallra ☐ b. Ndërtime ☐ c. Shërbime ☐	a. Mallra ☐ b. Ndërtime ☐ c. Shërbime ☐	a. Mallra ☐ b. Ndërtime ☐ c. Shërbime ☐
1.	Deklarata	-	Kopja e shpalljes e publikuar në shtyp/gazetë
2.		Së paku tri ftesa me shkrim të plotësuara, të nënshkruara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit) (nga Shtojca 1)	Ftesa me shkrim të plotësuara, të nënshkruara nga pranuesi i ofertës (tenderuesit) (nga Shtojca 1) – nuk është e obligueshme – **nëse ky është rasti/ vendosur nga përfituesi i grantit**
3.		Kopjet ecertifikatëspër regjistrimin e biznesittë secilit ngatenderuesit(përsë paku3tenderues)	Kopjet ecertifikatëspër regjistrimin e biznesittë secilit ngatenderuesit(përsë paku3tenderues)
4.		Kopjet enumrit fiskal tëtenderuesve(përsë paku3tenderues)	Kopjet enumrit fiskal tëtenderuesve(përsë paku3tenderues)
5.		Ofertat e pranuara (së paku 3)	Ofertat e pranuara (së paku 3)
6.		-	Vendimipërkrijimin ekomisionit për vlerësim
7.		Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga shtojca 2)	Deklarata për respektimin e rregullave për shmangien e konfliktit të interesit (nga shtojca 2)
8.		Deklarata përbesueshmërinë etenderuesit (nga shtojca 3)	Deklarata përbesueshmërinë etenderuesit (nga Shtojca 3)
9.		-	Deklarata për konfidencialitetin dhe neutralitetin (nga shtojca 4)
10.		Raporti për dhënien e tenderit	Raporti për dhënien e tenderit
11.		Kontrata e nënshkruarmeofertuesin e përcaktuar fitues	Kontrata e nënshkruarmeofertuesin e përcaktuar fitues

*Vlera dhetërësia e dokumenteve i referohet njëose më shumëblerjeve– varësisht nga lloji i blerjes(të veçanta janë ato për shërbime, mallra osendërtim); secilablerje mund t'i referohetnjë ose më shumë faturavetë paguara.

Shtojca nr. 6 Standardet minimale kombëtare për PBZHR- 2018

Tabela 1. Llogaritja e hapësirës së nevojshme për deponinë e plehut për 3 muaj/kafshë

Lloji i kafshëve	*Pleh i lëngët (m^3)*	*Pleh i ngurtë (m^2)*
Viçat/demat	2. 75	0. 75
Lopët qumështore	5	1. 5
Pula vojse (për 1000 pula)		5
Derra	0,375	

Varësisht prej tipit të mbajtjes dhe mënyrës së largimit të plehut, depoja e plehut duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Platforma e depos së plehut të ngurtë është e rrethuar me mur të betonit në tri anë me lartësi 1m.
- Është llogaritur që lartësia e plehut të hedhur/grumbulluar të jetë 2m
- Për çdo 20 m^2 sipërfaqe të plehut të ngurtë duhet të sigurohet 1m^3 rezervuar për lëngun e plehut (shih skicën).
- Përfituesi duhet të sigurohet që lëngu i plehut të mos depërtojë në tokë.
- Depoja e plehut të lëngët duhet të jetë e mbuluar.
- Depo e plehut të lëngët duhet të jetë së paku 10m larg burimit të ujit.

- Të dy tipat e depove të plehut duhet ndërtuar nga materialiqë nuk e lëshon ujin (psh. betoni i ngjeshur, plastika etj.).

- Varësisht prej tipit të mbajtjes dhe mënyrës së largimit të plehut, përfituesi duhet të ndërtojë njërën nga depot ose të dyja dhe këtë duhet ta sqarojë në planin e biznesit.



Skicë orientuese për ndërtimin e depos së plehut të ngurtë

Hapësira minimale për kafshë

Për lopë qumështore:
Shtrati/boksi (vendpushimi):
Gjerësia = 120 cm, gjatësia = 170 cm me kusht që lartësia e grazhdit krahasuar me nivelin e shtratit të mos jetë më shumë se 30 cm
Grazhdi: gjerësia = 60 cm,
Korridori në mes = 240 cm (në gjerësinë e korridorit nuk llogariten grazhdet)
Korridori pas shtretërve = 150 cm
Vendqëndrimi për viça së paku 1m²/kokë
Fermeri/investitori ka të drejtë të zbatojë hapësira më të mëdha, por jo më të vogla.

Tabela 2. Për viça dhe dema për majmëri:

Mosha e kafshës	Deri në 2 javë	2-8 javë	Mbi 8 javë
Gjatësia e shtratit		160 cm	170 cm
Gjerësia e shtratit		100 cm	120 cm
Gjerësia e grazhdit	35 cm	45 cm	50 cm

Nëse lopët mbahen në sistem të lirë: për çdo lopë duhet siguruar nga një shtrat me madhësi si më lartë dhe stalla duhet të ketë madhësi që siguron së paku 10 m²/lopë.

Nëse stalla ka padok (hapësirë për shëtitje të kafshëve),madhësia e tij duhet të jetë e tillë që siguron së paku 4,5 m²/lopë.

Të gjithë përfituesit e prodhimit të qumështit të lopëve duhet të kenë laktofriz ose nëse nuk kanë duhet të aplikojnë për laktofriz me madhësi të përshtatshme për kapacitetin e tyre prodhues.

Standardet për pula vojse në kafaz:

Kushtet minimale teknike të kafazeve të përmirësuar (sipas standardeve të BE-së) për pula vojse:

- Sipërfaqja minimale e kafazit së paku 2000 cm²,
- 750cm²/pulë vojse nga e cila 600 cmme lartësi 45 cm, me fole/strofull, me pjesën e shtruar për shpurdhje dhe çukitje dhe 15 cm shkop (purtekë) /pulë për qëndrim, e vendosur mbi pjesën e shtruar,
- qasja në ushqim së paku 12 cm për pulë,
- korridori në mes të baterive minimum 90 cm,
- në mes të dyshemesë dhe fundit të kafazeve duhet të mbetet një hapësirë prej 35 cm

Për pula vojse të mbajtur në dysheme:

Dendësia maksimale për pula vojse: nëntë (9) pula/m²

si dhe të plotësohen kushtet vijuese:

- Pajisjet lineare për ushqim të sigurojnë të paktën 10 cm për pulë, kurse ato rrethore të paktën 4 cm për pulë;

- govatat lineare të ujit të pijshëm duhet të sigurojnë së paku 2,5 cm për pulë ose govatat rrethore 1 cm për pulë. Kur furnizimi me ujë është me pikatore, për çdo 10 pula = 1 pikatore.

Vetëm për pula vojse:

- të paktën një fole për çdo shtatë pula.
- Nëse përdoren fole grupore, për 120 pula duhet siguruar së paku 1,2 m²
- 15 cm shkopinj (purteka)/pulë, pa tehe të mprehta, të ngritur mbi shtrojë dhe distanca horizontale mes tyre duhet të jetë së paku 30 cm, ndërsa distanca në mes të shkopinjve dhe murit duhet të jetë së paku 20 cm;
- të paktën 250 cm²shtrojë për pulë, shtroja zë të paktën një të tretën e sipërfaqes së dyshemesë*.

Ndriçimi

- ✓ Për lopë qumështore dhe viça, madhësia e dritareve të stallës duhet të jetë së paku sa 5% e sipërfaqes së dyshemesë.
- ✓ Pula vojse të mbajtura në dysheme, madhësia e dritareve të stallës duhet të jetë së paku sa 3% e sipërfaqes së dyshemesë.

*Për detaje shtesë shih rregulloren 1999/74/EC

Standardet minimale për shëndet dhe mirëqenie të derrave

Sipërfaqja minimale e dyshemesë varësisht prej masës së kafshës:

Masa e kafshës (kg)	Sipërfaqja (m²)
Deri në 10	0,15
> 10 deri 20	0,2
> 20 deri 30	0,3
>30 deri 50	0,4
>50 deri 85	0,55
>85 deri 110	0,65
>110	1,0

- Mbajtja lidhur e dosave është e ndaluar.
- Derrave duhet t'u sigurohet ndriçim me intensitet prej së paku 40 lux, për së paku 8 orë në ditë.

Për detaje shtesë shih Rregulloren 2008/120/EC

Shtojca nr. 7 Lista e investimeve të pranueshme

Tabela 1	**LISTA E SHPENZIMEVE TË PRANUESHME PËR MASËN 101**
101.1	**SEKTORI I PEMËVE**
101.1.1	***Investimet në ngritjen e pemishteve të reja dhe/ose rehabilitimi i pemishteve ekzistuese***
101.1.1.1	Punimet e kryera për mbjelljen e fidaneve dhe përgatitjen e tokës. Blerja e fidaneve të çertifikuara, sistemit mbajtës për fidane me shtylla të betonit ose të metalta (nuk pranohen shtylla nga druri apo materiale tjera) Blerja e materialit për rrethojë me shtylla të betonit ose të metalta Punimet e kryera për vendosjen e sistemit mbajtës dhe rrethojës Infrastruktura (shtyllat, teli, rrethoja, ujitja, mbrojtja kundër breshërit) për pemishtet ekzistuese
101.1.2	***Investimet në vendosjen e sistemit të ujitjes në pemishte.***
101.1.2.1	Punimet e kryera nga një palë e tretë për hapjen e puseve Blerja e gypave për ujitje Blerja e pajisjeve për hedhjen e ujit (spërkatje, vesim) Blerja e pompave Blerja e pajisjeve të TI duke përfshirë edhe programet (software) Punimet e kryera nga një palë e tretë për vendosjen e sistemit të ujitjes
101.1.2.2	Pajisje për furnizim me energji të ripërtritëshme dhe jo të ripërtritëshme, për funksionim të sistemit të ujitjes dhe pajisjeve kontrollim dhe monitorim
101.1.2.3	Blerja e rrjetave kundër breshërit, mbrojtjen ndaj zogjëve dhe pajisje për mbrojtje nga drita Blerja e sistemit mbajtës për rrjetë kundër breshërit Punimet e kryera nga një palë e tretë për vendosjen e rrjetave kundër breshërit dhe sistemit të tyre mbajtës
101.1.2.4	Ndërtimi ose renovimi i objekteve për makineri bujqësore dhe pajisje, magazinimin e karburantëve/lubrifikantëve, objektet e magazinimit për mbrojtjen e produkteve të bimëve, plehrave dhe pajisjeve për mbrojtje personale
101.1.3	***Investimet në makina dhe pajisje bujqësore për kultivimin e pemishteve, për mbrojtjen e bimëve, për shpërndarjen e plehut, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes.***
101.1.3.1	Traktorë special dhe kultivatorë për pemishte Makina për prodhimin e kompostit Automjete dhe rimorkio speciale për vjelje Blerja e pajisjeve dhe makinave speciale për hortikulturë (spërkatës, atomizerë), pajisje për shpërndarje të plehut, për mbjellje, për mulqerim, për vjelje, trajtim të kompostit etj.
101.1.3.2	Pajisje kompjuterike dhe software përfshirë sensorë që kanë lidhshmëri vetëm me pajisjet e pranueshme për njësitë prodhuese të vreshtave)

101.1.4	***Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve të trajtimit pasvjeljes, objektet për strehimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehëra artificiale***
101.1.4.1	Ndërtimi apo renovimi i objekteve ekzistuese ose blerja dhe vendosja e paneleve për depo të përhershme apo të përkohshme, depo me ajr të kondicionuar, hapësira për pastrim, klasifikim dhe paketim Blerja e makinave dhe pajisjeve për paraftohje, njësitë për ftohje dhe depo ftohëse. Blerja e makinave dhe pajisjeve për larje, pastrim, selektim, klasifikim, prerje, tharje, paketim dhe etiketim të frutave të freskëta, Blerja e pajisjeve për transport për përdorim brenda objektit: pirunier, rimorkio, kontejner, vinç, pirunier të dorës, karrocë apo pajisje tjera transportuese apo punuese. Pajisje për trajtimin e mbetjeve dhe deponimin e mbeturinave (përfshirë kompostimin) Materiale ndërtimi/komponente për instalimin e sherbimeve teknike per furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet perngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, prodhimin e energjisë dhe furnizimi i energjisëdheinstalimet, kullimi, rrjetet ekanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit tëujërave të zeza sigurimin ekërkesaveplotësuesehigjenikedhesanitare(përfshirëruajtjen e produkteve higjienike dhesanitare, si dhe zonëne punëtorëve), hapësirën administrative(zyre) dhepërinstalimin epajisjeve Blerja e kompjuterëve, programeve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, për monitorim, për regjistrim, kontrollim të ftohjes etj.
101.2	**SEKTORI I PERIMEVE**
101.2.1	**Investimet në ndërtimin dhe modernizimin e serrave permanente**
101.2.1.1	Ndërtimi i serrave nga plasmasi, polikarbon (plexi-glas) ose qelqi Materiale ndërtimi/ komponentë për ndërtim/renovimin e serrave
101.2.1.2	Pajisjeve speciale për serra, duke përfshirë makina për vendosje në vazo dhe mbushje, makina për vjelje, sistem ventilimi, sistem i ujitjes, Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë, etj.) Makina për prodhimin e kompostit Inkubatorë për rritje të fidanëve Blerja e kompjutereve, progameve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, monitorim dhe regjistrim, pastaj sisteme për kontrollimin e ftohjes në automjetet frigorifer etj.
101.2.1.3	Pajisje për furnizim me energji të ripërtritëshme dhe jo të ripërtritëshme, për funksionim të sistemit të ujitjes dhe pajisjeve kontrollim dhe monitorim Pajisje për ngrohje të serrës me kusht që ajo të arsyetohet ekonomikisht
101.2.1.4	Blerja dhe instalimi i pajisjeve për sigurimin e kushteve klimatike të kontrolluara dhe kultivimin pa dhé (soil-less)
101.2.1.5	Investime në vendosjen apo modernizimin e sistemit të ujitjes në serrë

	Punimet e kryera nga një palë e tretë për hapjen e puseve, Pajisje për hedhjen e ujit (spërkatje, vesim), pompat e ujit Pajisje të TI duke përfshirë edhe programme (software)
101.2.2	***Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve***
101.2.2.1	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve për trajtim të perimeve dhe patateve pas vjeljes, Ndërtimi apo renovimi i objekteve ekzistuese ose blerja dhe vendosja e paneleve për depo të përhershme apo të përkohëshme, depove për patate, hapësira për pastrim, klasifikim dhe paketim Blerja e makinave dhe pajisjeve për paraftohje, njësi për ftohje dhe depo ftohëse. Blerja e makinave dhe pajisjeve për larje, pastrim, selektim, klasifikim, prerje, tharje, paketim dhe etiketim, Blerja e pajisjeve për transport për përdorim brenda objektit: pirunier, rimorkio, kontejner, furgona, vinç, pirunier i vogël, karrocë apo pajisje tjera transportuese apo punuese. Ndërtimi i objekteve për strehimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, depove për pesticide dhe për plehëra
101.2.2.2	Materialendërtimi/komponentepër instalimin e shërbimeve teknike për furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet përngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, furnizimi me energji dhe instalimet, kullimi, rrjetet e kanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza/të ujit, pastrimit të ujit, Blerja e kompjuterëve, programeve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, për monitorim, për regjistrim, kontrollim të ftohjes, etj.
101.2.2.3	Pajisje për shërbimet teknike (furnizimi me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet për ngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, instalimet e rrymës elektrike, kullimi, rrjetet e kanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza, Pajisje për furnizim me energji të ripërtritëshme dhe jo të ripërtritëshme, për funksionim të deposë dhe pajisjeve kontrollim dhe monitorim Pajisje për ti plotësuar kërkesat higjienike dhe sanitare duke përfshirë pajisjet higjienike dhe sanitare edhe për punëtorët, si dhe për pastrimin e makinerive dhe pajisjeve
101.2.2.4	Makineri bujqësore (traktorë, kultivatorë, multi-kultivatorë) dhe pajisje përkultivimin e tokës, krasitje, mulqerim, kositje, pajisje për mbrojtjen e kulturave (spërkatës, atomizerë, pajisje për shpërndarjen e plehrave dhe makineri për vjelje/korrje)
101.2.3	***Pajisjet per trajtim pas vjeljes***
101.2.3.1	Pajisje për trajtim pas vjeljes, për kalibrim, klasifikim, pastrim, larje, tharje, dezinfektimin, zbulimin e metalit, qelqit apo materialeve të tjeratë ngurta Pajisje për prerje te frutave, paketim dhe etiketim Pajisje për para-ftohje, ftohje dhe frigorifer
101.2.3.2	Pajisje për manipulim, ngarkim-shkarkim, pajisje-pirunj, rimorkio transporti, mjet transportues me sistem rripi, pajisje për peshim
101.2.3.3	Pajisje dhe objekte për trajtimin e mbetjeve dhe depozitimin e mbeturinave (përfshirë kompostimin)

101.2.3.4	Pajisjet për monitorimin e cilësisë, sistemet e kontrollit, gjurmueshmërise, ruajtjen dhe shpërndarjen, pajisje kompjuterike dhe softwarëve përfshirë sensorët
101.3	**SEKTORI I PRODHIMIT TË QUMËSHTIT**
101.3.1	***Ndërtimi/ renovimi istallave për lopë, dele dhe dhi të qumështit***
101.3.1.1	Ndërtimi ose renovimi i stallave dhe objekteve përcjellëse, mjeltoreve dhe infrastrukturës përkatëse Ndërtimi apo renovimi i stallave të tipit të mbyllur, gjysëm të hapur apo të hapur Ndërtimi apo renovimi i mjeltoreve, dhomës për ruajtjen e qumështit dhe laktofrizat
101.3.1.2	Investime në modernizimin e pajisjeve për mjelje dhe ftohje dhe ruajtje të qumështit duke përfshirë dhomën e qumështit dhe laktofrizat Pajisjet për mjelje, mjeltore, sistemi i mbyllur i mjeljes, pompat vakum dhe sistemet e kontrollit, sistemet për matjen e qumështit Pajisje për pastrimin e sistemit të mjeljes
101.3.1.3	Ndërtimi apo renovimi i objekteve përcjellëse siq janë depot e ushqimit të koncentruar dhe voluminoz, depo për sillazh, silosëve duke përfshirë hapësirat për përgatitjen e ushqimit, për trajtim dhe paketim të tij. Ndërtimi i objekteve ose dhomave për deponimin e medikamenteve, materialit për higjienë, për veteriner, për qëndrim të punëtorëve etj. Investime në largimin, trajtimin dhe deponimin e plehut, Ndërtimi apo renovimi i depove për grumbullimin dhe deponimin e plehut Tank/gropë për plehun e lëngshëm Pajisje për përzierjen dhe nxjerrjen/pompimin e plehut të lëngët Pajisje automatike për largimin e plehut Pompa dhe sisteme të ajrosjes për plehë të lëngshëm Pajisje për shpërndarjen e plehut të lëngshëm (p.sh. cisterna) dhe atij të ngurtë.
101.3.1.4	Investime për instalimin e sherbimeve teknike per furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet perngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, prodhimin e energjisë dhefurnizimi me rrymë elektrike, kullimi, rrjetet ekanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit tëujërave të zeza/të ujit, brushat, pajisje të peshimit
101.3.1.5	Investime për rrethimin e fermave blegtorale, zonat e mbarështimit, kontrollin e lëvizjes në natyrë, barrierat dezinfektuese, qasje rrugore dhe rrugë në-ferme për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme të fermës
101.3.1.6	Pajisje për shënjimin e kafshëve dhe regjistrimin e të dhënave dhe të pajisjeve kompjuterike dhe software përfshirë sensorë (që kanë të bëjnë vetëm me pajisjet e pranueshme për aktivitetet e fermave të qumështit)
101.3.1.6	Investime per pikat grumbulluese te qumështit: Ndërtimi, riparimi ose zgjerimi i objekteve për pranimin e qumështit

	Laktofrizë, frigoriferë, bojler, ventilatorë, Cisternë të izoluar nga inoksi për transportim të qumështit deri në qumshtore Pajisje për matjen e cilësisë së qumështit si pajisje për matjen e yndyrës, pH-së, mbetjeve të antibiotikëve, qelizave somatike, mikroorganizmave etj. Peshore, pompë për nxjerrjen e qumështit, bidona inox, kulluese Gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike, stabilizatorë të rrymës el., pajisje për prodhimin e energjisë së ripërtritëshme
101.3.2	***Mekanizimi dhe pajisjet bujqësore***
101.3.2.1	Makineri bujqësore: përzierse (mikserë), TMR (total mix ratio), makina kositëse, presa, grabujë tedders, makina për grimcim të sillazhit, pajisje dhe makina për përgatitjen e sillazhit në fermë, makina për kultivim të tokës (traktorë, kultivatorë, multi-kultivatorë), makina për mbjellje, mbrojtjen e kulturave (spërkatës, atomizerë), për shpërndarje të plehut, për kositje dhe për kultivimin e livadheve (përfshirë rotoballat)
101.4	**GRUPI I INVESTIMEVE PËR PRODHIM TË MISHIT**
101.4.1	***Ndërtimi/ renovimi iobjekteve të fermavepër mbarështim***
101.4.1.1	Ndërtimi/ renovimi i stallave të tipit të mbyllur, gjysëm të hapur apo të hapur dhe objekteve përcjellëse dhe infrastrukturës përkatëse për gjedhë për trashje
101.4.1.2	Ndërtimi apo renovimi i objekteve përcjellëse siq janë depot e ushqimit të koncentruar dhe voluminoz, depo për sillazh, silosëve duke përfshirë hapësirat për përgatitjen e ushqimit, për trajtim dhe paketim të tij. Ndërtimi i objekteve ose dhomave për deponimin e medikamenteve, materialit për higjienë, për veteriner, për qëndrim të punëtorëve etj. Investime në largimin, trajtimin dhe deponimin e plehut, Ndërtimi apo renovimi i depove për grumbullimin dhe deponimin e plehut Tank/gropë përplehunelëngshëm Pajisje për përzierjen dhe nxjerrjen/pompimin e plehut të lëngët Pajisje automatike për largimin e plehut Pompa dhe sisteme të ajrosjes për plehë të lëngshëm Pajisje për shpërndarjen e plehut të lëngshëm (p.sh. cisterna) dhe atij të ngurtë.
101.4.1.3	Investime për instalimin e sherbimeve teknike per furnizim me ujë, sistemet e ventilimit, sistemet per ngrohje/ftohje, kushtet mikro-klimatike, prodhimin e energjisë dhefurnizimi me rrymë elektrike, kullimi, rrjetet ekanalizimeve/rezervuarëve, të trajtimit të ujërave të zeza/të ujit, brushat, pajisje tëpeshimit
101.4.1.4	Investime për rrethimin e fermave blegtorale, zonat e mbarështimit, kontrollin e lëvizjes në natyrë, barrierat dezinfektuese, qasje rrugore dhe rrugë në-ferme për kryerjen e aktivitete vetë nevojshme të fermës

101.4.1.5	Pajisje për shënjimin e kafshëve dhe regjistrimin e të dhënave dhe të pajisjeve kompjuterike dhe software përfshirë sensorë (që kanë të bëjnë vetëm me pajisjet e pranueshme për aktivitetet e fermave të qumështit)
101.4.2	***Mekanizimi dhe pajisjet bujqësore***
101.4.2.1	Makineri bujqësore: përzierse (mikserë), TMR (total mix ratio), makina kositëse, presa, grabujë tedders, makina për grimcim të sillazhit, pajisje dhe makina për përgatitjen e sillazhit në fermë, makina për kultivim të tokës (traktorë, kultivatorë, multi-kultivatorë), makina për mbjellje, mbrojtjen e kulturave (spërkatës, atomizerë), për shpërndarje të plehut, për kositje dhe për kultivimin e livadheve (përfshirë rotoballat), Pajisje për transportimin e brojlerëve në therrtore (romorkio, kafazë)
101.5	**GRUPI I INVESTIMEVE PER PRODHIMIN E RRUSHIT**
101.5.1	***Investime në ngritjen/rehabilitimin e vreshtave***
101.5.1.1	Investime në ngritjen/rehabilitimin e vreshtave (mbjellja, konvertimi, zëvendësimi) Punimet nga një palë e tretë përmbjelljen, përgatitjen e tokës me përjashtim të plehërimit të tokës Blerja e fidaneve të çertifikuara Blerja e materialit për sistemin mbajtës të hardhive Blerja e materialit për rrethojë Blerja e plasmasit për mbulimin e hardhive, vetëm për rrush të tryezës. Punimet nga një palë e tretë për vendosjen e sistemit mbajtës dhe rrethojës
101.5.1.2	***Investime në vendosjen ose modernizimin e sistemit të ujitjes***
101.5.1.2.1	Investime në vendosjen ose modernizimin e sistemit të ujitjes sipas praktikave të shfrytëzimit eficient të ujit dhe energjisë Punimet e kryera nga një palë e tretë për hapjen e puseve Blerja e gypave për ujitje Blerja e pajisjeve për hedhjen e ujit (spërkatje, vesim) Blerja e pompave Blerja e pajisjeve të TI duke përfshirë edhe programet (software) Punimet e kryera nga një pale e tretë për vendosjen e sistemit të ujitjes
101.5.2	Investime në vendosjen e rrjetave kundër breshërit
101.5.2.1	Blerja e rrjetave kundër breshërit, Punimet e kryera nga një palë e tretë për vendosjen e rrjetave kundër breshërit dhe sistemit të tyre mbajtës, rrethojës dhe vendosjen e sistemit te mbulimit te hardhive me plasmas
101.5.3	***Investimet në makineri dhe pajisje bujqësore për kultivim të vreshtave, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes***
101.5.3.1	Traktorë special dhe kultivatorë Automjete dhe rimorkio speciale për vjelje Blerja e pajisjeve dhe makinave speciale për vreshtari, për shpërndarje, për mbjellje, për mulqerim, trajtim të kompostit etj.

101.5.4	***Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve, për strehimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, depove për produkte, për pesticide dhe për plehëra artificiale***
101.5.4.1	Ndërtimi apo renovimi i objekteve ekzistuese ose blerja dhe vendosja e paneleve për depo të përhershme apo të përkohshme, hapësira për pastrim, klasifikim dhe paketim Blerja e makinave dhe pajisjeve për paraftohje, ftohje dhe depo me ftohje Blerja e makinave dhe pajisjeve për larje, pastrim, selektim, klasifikim, prerje, tharje, paketim dhe etiketim, Blerja e pajisjeve për transport për përdorim brenda objektit: pirunier, rimorkio, kontejner, furgona, vinç, pirunier i dorës, karrocë apo pajisje tjera transportuese apo punuese Blerja e kompjuterëve, programeve speciale dhe pajisjeve speciale teknologjike për inspektim, për monitorim, për regjistrim, kontrollim të ftohjes etj.
101.5	**GRUPI I INVESTIMEVE PER PRODHIMIN E VEZËVE**
101.6.1	Ndërtimi/renovimi i stallave për pula vojse dhe objekteve përcjellëse, si dhe infrastruktures përkatëse të fermës Objekte per ruajtje te vezeve, dhoma ftohese, pajisje per ftohje
101.6.2	Investimet në kafazë, vetëm në rast të përmbushjes së standardeve të BE-së
101.6.3	Ndërtimi ose renovimi i objekteve përcjellëse siq janë depot e ushqimit duke përfshirë pajisjet për përgatitjen e ushqimit, përdorimin dhe paketimin e tij
101.6.4	Investime në pajisje për prodhim të energjisë nga burime të ripërtritëshme
101.6.5	Investime për prodhimin e koncentratit, 50% e të cilit duhet të jetë për nevoja të fermës
101.6.7	Investime në makineri dhe pajisje për trajtim të vezëve, makine per vulosje/shenjezim, shirita transportues per bartjen e vezeve, për klasifikim të vezëve, vetëm për fermat me më shumë se 15,000 pula vojse
101.6.8	Investime në sisteme për largimin, trajtimin dhe deponimin e plehut
	SHPENZIMET E PËRGJITHSHME PËR MASËN 101
101.A1	***Lista e shpenzimeve të përgjithshme për përgaditjen e planit të biznesit***
101.A1.1	Pagesat e konsulencës për përgatitjen e planit të biznesit, projekt propozimit, analiza të tokës, analiza të ujit dhe analiza tjera të nevojshme.
101.A1.2	Pagesat për arkitektët dhe inxhinierët e shërbimeve 'në çdo fazë të planifikimit: përgatitjen e dizajnit fillestar, studimeve të fizibilitetit, projektin teknik, projektet mbështetëse etj.
101.A1.3	Shpenzime të tjera për mbledhjen e dokumenteve mbështetëse siq janë leja e ndërtimit, vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe leje apo licenca tjera të nevojshme
101.A2	***Shpenzimet e përgjithshem për zbatimin e projektit***

101.A2.1	Pagesat e konsulencës për ofrimin e asistencës teknike për menaxhimin e projektit gjatë zbatimit të projektit
101.A2.2	Pagesat për arkitektët dhe shërbimet e inxhinierëve për mbikëqyrjen e ndërtimit
101.A2.3	Pagesat për ofrimin e shërbimeve të ndërtuesve
101.A4	***Shpenzimet e publicitetit dhe informimit në nivel të projektit***
101.A3.1	Dizajnimi i materialit publicitar dhe informues
101.A3.2	Shtypja e materialit publicitar dhe atij informues
101.A3.3	Elementet e ndërtimit për pllakata/billborde
	LISTA E PUNËVE TË PRANUESHME PËR MASËN 101
101.B1	Aktivitetet që kane të bëjnë me demolimin - demolimi i ndërtimeve ekzistuese - transporti i materialeve në deponinë më të afërt aktivitetet ndihmëse
101.B1.1	Punët e tokës - gërmimi i sipërfaqes humusore - gërmimi i tokës - gërmimi i themeleve - ndërtimi i argjinaturës - ngritjen dhe përforcimin e bazës - transporti i materialit te germuar - aktivitetet ndihmëse
101.B1.2	Punët me beton - ndërtimi i bazës nga betoni - vendosja e konstruksioneve të nevojshme - vendosja e armaturës - ndërtimi i dyshemesë se betonit dhe argjinaturat e çimentos - puna e betonimit, rregullimi i terenit, qasjes në rrugë /lidhjen rrugore - vendosjen e elementeve të duhura të parafabrikuara - hapja e sistemit të kanaleve - aktivitetet ndihmëse
101.B1.3	Punimet me blloka/tulla - murimi - izolimi horizontal dhe vertikal i objektit - suvatim i tavanit dhe mureve në objektit - ndërtimi i rrethojës, rregullimi i terenit, rrugët / lidhjeve rrugore - vendosjen e elementeve të parafabrikuara - ndërtimi i elementeve te vogla brenda objektit (oxhakut, sistemit te ventilimit etj) - aktivitetet ndihmëse

101.B1.4	Punimet nga druri - ndërtimi i të gjitha elementeve që lidhen me objektin e ri apo adaptimin e objektit të vjetër - vendosja e konstruksioneve të drurit (bazës, trareve dhe ndërtimet e kulmeve) - punë ndërtuese nga druri siç janë dyshemeja, rregullimi i hapesires, rrethojat e rrugës - vendosja e konstruksioneve të vogla nga druri - aktivitetet ndihmëse
101.B2	Punimet e izolimit dhe fasadës - izolimi - fasada - vendosjen e elementeve të parafabrikuara - aktivitetet ndihmëse
